



Krijimi i programeve të trajtimit për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave

**Analizë e kornizës ligjore në Kosovë*
dhe raport i praktikave të mira**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Krijimi i programeve të trajtimit për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave

Analizë e kornizës ligjore në Kosovë* dhe raport i praktikave të mira

Autore:

Cristina Oddone

Donjeta Morina
Konsultente vendore

Janar 2021

*Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territor, institucione, ose popullsi, në këtë tekst duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe pa paragjykuar statusin e Kosovës.

Përmbajtja

Mirënjohjet	4
Shkurtesat dhe Akronimet	5
Përmbledhje ekzekutive	7
1. HYRJE	9
1.1 Fushëveprimi i studimit	9
1.2 Metodologjia	10
2. STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI PROGRAMET E KRYERËSVE TË DHUNËS	11
2.1 Nga praktika e komuniteteve deri tek ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut	11
2.2 Neni 16 i Konventës së Stambollit	12
2.3 Neni 16 në Raportet e GREVIO-s	13
2.4 Standardet dhe udhëzimet e cilësisë për punën me kryerësit e dhunës	13
3. HISTORIA E KOSOVËS*	15
3.1 Konteksti vendor	15
3.2 Barazia gjinore dhe dhuna ndaj grave: një perspektivë historike	15
3.3 Situata aktuale dhe përhapja e dhunës në familje në Kosovë*	16
4. PROGRAMET E KRYERËSVE TË DHUNËS NË KOSOVË*	19
4.1 Masat ligjore dhe të politikave që synojnë kryerësit e dhunës në familje	19
4.2 Praktikat eksperimentale për trajtimin e kryerësve të dhunës	20
4.3 Zbatimi i përgjithshëm i programeve për kryerësit e dhunës në tërë Kosovën*	22
4.4. Konkluzione	35
5. PROGRAMET DHE PRAKTIKAT NGA RAJONI I BALLKANIT	35
Rekomandime	41
SHTOJCA I: KORNIZA PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE	47
SHTOJÇË II : LISTA E SUBJEKTEVE TË KONSULTUARA	48
Referenca	49

Mirënjohjet

Ky hulumtim u zhvillua në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës "Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë* - Faza II".

Këshilli i Evropës dëshiron të falënderojë konsulentet e projektit, znj. Donjeta Morina për ndihmën në hulumtimin e të dhënave dhe znj. Cristina Oddone për hartimin e këtij raporti.

Gjithashtu, falënderime të veçanta u drejtohen autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesit në Kosovë* për kontributin e tyre të vlefshëm gjatë zhvillimit të këtij hulumtimi.

Shkurtesat dhe Akronimet

KEDNG	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave
LKGV	Linja e Këshillimit për gra dhe vajza (Shqipëri)
LKBD	Linja e Këshillimit për burra dhe djem (Shqipëri)
QSSZhQ	Qendra për Studime Sociale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm
QPS	Qendra për Punë Sociale
DhF	Dhuna në familje
BE	Bashkimi Evropian
FRA	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut
DhBGj	Dhuna me bazë gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave
AKS	Agjencia Kosovare e Statistikave
QKTT	Qendra e Kosovës për Trajtimin e Traumës
IPFK	Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës
PKBGj	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
LBGj	Ligji për barazinë gjinore
LMD	Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
ZKGJ	Zyrtarët Komunalë për Barazi Gjinore
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
UMEP	Urdhër për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme
NjVKB	Njësia për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve
UNDP	Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
DhNG	Dhuna ndaj drave
WAVE	Gratë Kundër Dhunës Evropë
WSSI	Nisma për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Grave
WWP EN	Rrjeti Evropian i Punës me Kryerësit e Dhunës

Përmbledhje ekzekutive

Pas ligjit të parë për Barazinë Gjinore në vitin 2004, Kosova* ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të tejkaluar diskriminimin me bazë gjinore, duke zhvilluar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe politike për promovimin e të drejtave të grave dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Duke bërë një vlerësim të përparimit të deritanishëm, ky hulumtim synon të vlerësojë gjendjen në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës, kryesisht adresimin e boshllëqeve dhe mangësive në konceptimin dhe zbatimin e masave që synojnë abuzuesit në familje. Meqenëse Kuvendi i Kosovës* e votoi zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të Konventës së Stambollit në shtator 2020, përgjigja ndër-institucionale ndaj dhunës në familje kërkon edhe krijimin e programeve për kryerësit e dhunës (neni 16 “Programet e ndërhyrjes parandaluese dhe trajtimit”).

Ky studim kujton se si krijimi i programeve për kryerësit e dhunës gradualisht është bërë një çështje shqetësuese në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe përshkruan standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe udhëzimet për këtë drejtim. Raporti pastaj hulumton gjendjen në Kosovë*, bazuar në analizën e dokumentacionit dhe hulumtimin cilësor. Intervistat e hollësishme me palët kryesore të interesit kanë zbuluar gjetje të rëndësishme, për shembull ekzistencën e dy iniciativave eksperimentale që synojnë kryerësit e dhunës: një projekt pilot i filluar nga Shtëpia e Sigurt në Gjakovë dhe një program i ngritur nga Qendra Sit në Prishtinë. Studimi pastaj detajon zbatimin praktik të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën* duke marrë parasysh tri fusha kryesore: (1) Qasjen në programet për kryerësit e dhunës; (2) Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse të grave; (3) Perspektivën gjinore dhe standardet minimale për praktikë. Çdo seksion përshkruan kërkesat për krijimin e programeve, siç thuhet në standardet ndërkombëtare dhe në raportet fillestare të vlerësimit nga GREVIO.

Analiza tregon një përdorim akoma të kufizuar dhe të pasaktë të programeve për kryerësit e dhunës në familje dhe një numër të ulët të shkelësve që i nënshtrohen trajtimit, dhe konfirmon hetimet e mëparshme që sugjerojnë se trajtimi i kryerësve të dhunës, siç parashikohet nga Konventa e Stambollit, *de facto* nuk është në dispozicion në Kosovë* (Këshilli i Evropës 2017). As programet e menaxhimit të zemërimit në qendrat e paraburgimit, as trajtimi i shëndetit mendor të ofruar në spitalet psikiatrike, duket se nuk përmbushin standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Protokollet ose marrëveshjet me shërbimet mbështetëse të grave, që synojnë të ofrojnë mbrojtje dhe siguri për viktimat, duket se mungojnë. Legjislacioni dhe politikat aktuale që fokusohen tek kryerësit e dhunës nuk kanë perspektivë gjinore dhe kanë mungesë të të kuptuarit të dhunës në familje si çështje publike. Mbizotërimi i një qasje mjekësore duke u përqendruar në raste individuale të kryerësve të dhunës me probleme të shëndetit mendor ose me probleme të varësisë nuk arrin të adresojë dhunën e burrave ndaj grave si fenomen shoqëror i lidhur me pabarazitë strukturore me bazë gjinore.

Raporti rekomandon zhvillimin e njohurive dhe kompetencave për trajtimin e kryerësve të dhunës në Kosovë*, duke siguruar trajnim adekuat të profesionistëve, duke adoptuar udhëzime të qëndrueshme dhe duke përcaktuar kriteret e licencimit për organizatat përgjegjëse për zbatimin e programeve. Poashtu, ai sugjeron edhe reformimin e kornizës legjislative dhe të politikave në lidhje me zbatimin e programeve dhe përmirësimin e iniciativave në fushën e parandalimit, veçanërisht duke synuar djemt dhe burrat. Praktikrat më të mira nga shtetet palë në Konventën e Stambollit mund të shërbejnë si referencë për të konceptuar dhe krijuar programe për kryerësit e dhunës në Kosovë*. Përveç kësaj, raporti ofron shembuj të iniciativave premtuese nga vendet e tjera të Ballkanit.

1. Hyrje

Dhuna ndaj grave është njohur ndërkombëtarisht si formë e diskriminimit ndaj grave dhe si shkelje e të drejtave të njeriut. Të dhënat kanë treguar se një në tri gra në Bashkimin Evropian (BE) ka përjetuar një formë të sulmit fizik dhe/ose seksual që nga moshën 15 vjeç (FRA 2014). Dhuna në familje në veçanti prek gratë në mënyrë disproporcionale: Ndonëse burrat mund të jenë gjithashtu shënjestra të dhunës nga partneri intim, megjithatë gratë përbëjnë shumicën e viktimave dhe burrat shumicën e kryerësve të dhunës.

Me synimin për të ndryshuar qëndrimet dhe kapërcyer stereotipet gjinore, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) thekson qartë nevojën e përfshirjes së djemve dhe burrave në parandalimin e dhunës ndaj grave. Para se ndonjë djalë apo burrë të bëhet kryerës i mundshëm i dhunës, ka hapësirë të mjaftueshme për t'iu mundësuar atyre të funksionojnë në marrëdhënie respektuese jo të dhunshme me gratë.

Përfshirë në Kapitullin III mbi "Parandalimin", neni 16 i Konventës së Stambollit kërkon që shtetet palë të krijojnë programe për kryerësit e dhunës që synojnë kryerësit e dhunës në familje dhe kryesit e dhunës seksuale. Hulumtimet dhe praktikët në këtë fushë kanë treguar që këto ndërhyrje, qoftë të bazuara në pjesëmarrje vullnetare apo të detyrueshme, mund të zvogëlojnë rreziqet për forma të mëtejshme dhe më të rënda të abuzimit. Në kontekstin e një procedure vlerësimi nga një vend në tjetrin, Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) - organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit nga shtetet palë - ka vëzhguar një gamë të gjerë praktikash në lidhje me këtë dispozitë. Programet për kryerësit e dhunës mund të zbatohen nga organizata të shoqërisë civile ose nga agjenci shtetërore siç janë shërbimet sprovuese dhe administratat e burgjeve. Në të gjitha rastet, ato duhet t'i japin një rëndësi të madhe sigurisë së viktimave dhe për këtë qëllim ato duhet të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të grave dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikët më të mira.

Projekti i Këshillit të Evropës "Fuqizimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë* - Faza II" përqendrohet në forcimin e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për mbështetjen e shërbimeve për viktimat dhe për krijimin e programeve për kryerësit e dhunës, dhënien e drejtësisë si dhe zgjerimin e nismave për ngritjen e vetëdijes për ta luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në përputhje me standardet e përcaktuara në Konventën e Stambollit.

1.1 Fushëveprimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të vlerësojë kornizën aktuale ligjore dhe të politikave në Kosovë* në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës me bazë gjinore. Objektiva të tjera janë: identifikimi i boshllëqeve dhe nevojave në këtë fushë; gjetja e përvojave të zbatimit praktik të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë vendin, përfshirë praktikët eksperimentale dhe projektet pilot; siguri i shembujve ilustrues të praktikave premtuese dhe të veçuara nga vendet e tjera; propozimi i rekomandimeve për veprime në të ardhmen, në përputhje me standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare.

Megjithëse neni 16 i Konventës së Stambollit kërkon edhe programe për kryesit e dhunës seksuale, ky raport do të përfshijë vetëm kryerësit e dhunës në familje. Deri më tani nuk ka informacion në dispozicion për ndonjë legjislacion specifik, standarde, protokolle ose programe në dispozicion që synojnë kryesit e dhunës seksuale në Kosovë*. Ky hendek mund të varet nga fakti se në Kosovë* dhuna seksuale dhe përdhunimi kanë marrë më pak vëmendje - në aspektin e politikave dhe legjislacionit - nëse krahasohet me fenomenin e dhunës në

familje, ku udhëzimet dhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) janë zhvilluar dhe implementuar në masë të madhe. Edhe nëse dhuna seksuale dhe përdhunimi, përfshirë përdhunimin martesor, mbeten të përhapura dhe të nën-raportuara në Kosovë*, strategjitë specifike për ta trajtuar këtë çështje nuk janë krijuar ende (RrGK 2016; WAVE 2019). Aktualisht, asnjë politikë specifike nuk përqendrohet në dhunën seksuale dhe nuk ekzistojnë shërbime të specializuara mbështetëse për gratë që kanë qenë të ekspozuara ndaj kësaj forme abuzimi, siç janë Qendrat e Krizave të Përdhunimit ose mjetet mjeksore për vlerësimin e përdhunimit për profesionistët shëndetësor. Në rast se një kornizë e përgjithshme mbi dhunën seksuale do të zhvillohet më tej në Kosovë*, programet për kryesit e dhunës seksuale duhet të parashikohen gjithashtu.

1.2 Metodologjia

Ky studim bazohet si në analizën e dokumentacionit edhe në hulumtimin cilësor. Analiza e dokumentacionit konsistoi në një rishikim të dokumenteve zyrtare dhe raporteve të shumta në dispozicion mbi temën e barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë*. Burimet përfshinin studime të publikuara nga Këshilli i Evropës dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, organizata ndërkombëtare, autoritete vendore, shoqëri civile, OJQ të grave dhe hulumtime akademike. Një listë e plotë e dokumenteve të konsultuara është në dispozicion në bibliografi. Shumica e studimeve janë përqendruar në përgjigjen institucionale ndaj grave viktime të dhunës me bazë gjinore në Kosovë* dhe pak informata janë në dispozicion për zbatimin e programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën*. Analiza ka theksuar disa boshllëqe në lidhje me mekanizmat e referimit, kurrikulën dhe qasjet e trajtimit të kryerësve të dhunës, procesin e akreditimit dhe trajnimin e profesionistëve në përputhje me standardet minimale ndërkombëtare, ndër të tjera.

Kufizimet sanitare të vendosura si pasojë e pandemisë COVID-19 kanë parandaluar çdo mundësi për të kryer vizita në terren dhe për të organizuar diskutime në fokus grupe siç ishte planifikuar fillimisht. Prandaj të gjitha takimet janë mbajtur në internet midis qershorit dhe dhjetorit 2020. Intervistat e hollësishme me autoritetet kyçe dhe palët e interesit ofruan një pasqyrë të nevojave kryesore kombëtare në këtë fushë, si dhe sfidat specifike në adresimin e kryerësve të dhunës duke i dhënë prioritet sigurisë së viktimave. Takimet në internet përfshinin 15 takime grupe me 21 autoritete kryesore dhe palë të interesit, ekspertë dhe profesionistë, *ndër të tjera* përfaqësues nga institucionet publike, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të. Për shkak të çështjeve të lidhjes në internet, në disa raste nuk ishte e mundur të kryheshin intervistat, kështu që është përdorur dhe pyetësori me shkrim. Aty ku ishte e nevojshme, informacioni plotësues u dha me shkrim. Shumica e intervistave janë kryer në anglisht përveç nëse personi preferonte të fliste shqip. Poashtu, në të gjitha intervistat është ofruar interpretimi konsektiv në/nga anglishtja. Lista e organizatave dhe subjekteve që janë kontaktuar mund të gjendet në Shtojcën II.

Kapitulli 2 përshkruan standardet kryesore ndërkombëtare në lidhje me programet për kryerësit e dhunës, veçanërisht Konventën e Stambollit. Kapitulli 3 rishikon politikat dhe masat ekzistuese vendore për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Kapitulli 4 i raportit shqyrton zbatimin aktual të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën*. Pas përshkrimit të dy programeve eksperimentale, njëri në Gjakovë dhe tjetri në Prishtinë, analiza përqendrohet në tri fusha kryesore tematike, që dalin nga vlerësimet e vendeve të GREVIO-s mbi zbatimin e Nenit 16 të Konventës së Stambollit:

- 1) Qasja në programet për kryerësit e dhunës;
- 2) Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse të grave;
- 3) Perspektiva gjinore dhe standardet minimale për praktikë.

Kërkesat për secilën fushë janë përmbledhur në një tabelë të përgjithshme, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe në çështjet e adresuara nga GREVIO në raportet bazë të vlerësimit të publikuara deri më tani. Çdo pjesë është i ndarë në tri nën-pjesë: (i) Përshkrimi i standardeve ndërkombëtare dhe parimeve udhëzuese për praktikën; (ii) Shembuj specifik të zbatimit të Nenit 16 nga shtetet palë të nxjerrë nga raportet ekzistuese të GREVIO-s; (iii) Vlerësimi i gjendjes aktuale në Kosovë*, përfshirë boshllëqet dhe mangësitë. Kapitulli 5 përshkruan programe nga vendet e tjera të Ballkanit, përkatësisht Shqipëria dhe Kroacia, dhe ofron një listë të programeve për kryerësit e dhunës që funksionojnë në rajon. Shembujt kanë për qëllim kultivimin e të kuptuarit më mirë të Nenit 16 dhe mund të sugjerojnë rrugë për të krijuar programe në përputhje me Konventën e Stambollit dhe me standardet e tjera ndërkombëtare.

2. Standardet ndërkombëtare mbi programet e kryerësve të dhunës

2.1 Nga praktika e komuniteteve deri tek ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Puna me kryerësit e dhunës filloi rreth viteve 1970 si praktikë eksperimentale profesionale që synonte rehabilitimin e burrave të dhunshëm. Së pari në Amerikën e Veriut dhe në Mbretërinë e Bashkuar (MB), më vonë në vendet e tjera Evropiane, programe të tilla janë zhvilluar si një nga strategjitë që mund të kontribuojnë në sigurinë e viktimave dhe mund të zvogëlojnë përsëritjen e veprës së dhunës (Këshilli i Evropës 2014; Westmarland dhe Kelly 2012, 2016). Duke ndjekur shembullin e modelit pararendës Duluth (Pence dhe Paymar 1993) dhe programi Emerge (Gondolf 1985; Gondolf dhe Russell 1986), në shumicën e rasteve këto ndërhyrje të para kishin për qëllim përgjigjet e koordinuara të komuniteteve ndaj dhunës në familje, në bashkëpunim me shërbimet mbështetëse të grave. Duke i mbajtur përgjegjës kryerësit e dhunës për aktet e tyre, programet për kryerësit e dhunës kishin për qëllim të përmirësonin përgjigjet si ndaj viktimave ashtu edhe ndaj shkelësve.

Që nga vitet 1970, kur dhuna ndaj grave u shfaq si çështje e shqetësimit publik dhe jo thjesht çështje private, si hulumtimet, ashtu edhe praktikat janë përqendruar me të drejtë në përjetimin e viktimave dhe i kanë dhënë prioritet nevojës së tyre për mbrojtje dhe mbështetje. Sidoqoftë, punëtorët e strehimoreve filluan të vërejnë se gratë do të referoheshin vazhdimisht në shërbimet e specializuara pasi që sjellja e abuzuesit vështirë se reflektonte ndonjë ndryshim. Për më tepër, adoptimi i një fokusi të drejtësisë penale tregoi kufijtë e një qasje vetëm ndëshkuese ndaj kryerësve të dhunës, duke çuar drejt një përpjekje për iniciativë rehabilitimi në fillimin e viteve 1990 (Hearn, 1998). Që nga vitet 2000, disa programe për kryerësit e dhunës u zbatuan në të gjithë Evropën, megjithëse jo në mënyrë të vazhdueshme dhe pa një qasje të standardizuar.

Dokumenti përfundimtar i Konferencës Botërore për Gra i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) i Pekinit 1995 përmban referencën e parë për “nevojën për të rehabilituar kryerësit e dhunës në familje” dhe në fillim të viteve 2000 Këshilli i Evropës nisi disa iniciativa mbi këtë temë specifike. Seminari i vitit 1999 “Burrat dhe dhuna ndaj grave” i mbajtur në Strasburg bashkoi ekspertë ndërkombëtarë për të diskutuar dhunën e burrave ndaj grave dhe çoi në rekomandimin e Komitetit të Ministrave për Mbrojtjen e Grave ndaj Dhunës. Rekomandimit 2002(5) përcakton një përkufizim të qartë të “kryerësve të dhunës”¹, ofron indikacione specifike për zbatimin e programeve² për kryerësit e dhunës dhe nënvizon lidhjen midis dhunës dhe ndërtimit shoqëror të karakterit mashkullor³. Ngjarje të tjera të Këshillit të Evropës ndoqën miratimin e Rekomandimit 2002(5), të tilla si seminarin “Masat që kanë të bëjnë me burrat kryerës të dhunës në familje” në vitin 2003, “Trajtimi terapeutik i burrave kryerës të dhunës brenda familjes” në vitin 2004 dhe “Dhuna brenda familjes: roli i burrave” në vitin 2005.

Po atë vit, Komisioni Evropian lancoi Programin Daphne II (2006-2008), “Puna me Kryerësit e Dhunës në Familje në Evropë - WWP”⁴, që synon shkëmbimin e praktikave më të mira dhe zhvillimin e standardeve uniforme në punën me kryerësit e dhunës në familje. Disa vite më vonë, në vitin 2008, Këshilli i Evropës publikoi një përmbledhje të standardeve minimale për shërbimet, duke përfshirë një seksion mbi veprimet që synojnë kryerësit

1 KiE, Rekomandimi Rec 2002 (5) Mbrojtja e Grave ndaj Dhunës (Këshilli i Evropës 2002), f. 21, para. 31.

2 Supra 25, f. 12, para. 50-53.

3 Supra 25, f. 27, para. 54.

4 Projekti Evropian Daphne II, Numri i Referencës së Projektit: 2005-1-217-W, https://ec.europa.eu/justice/grants/results/daphne-toolkit/content/working-perpetrators-domestic-violence-europe_en

e dhunës në familje (Këshilli i Evropës 2008). Standardet tregojnë qartë se siguria për gratë dhe fëmijët si dhe nevoja për të punuar në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të grave janë të një rëndësie të madhe kur krijohen programe për kryerësit e dhunës. Në të njëjtin drejtim, Doracaku i OKB-së i vitit 2010 për Legjislacionin mbi Dhunën ndaj Grave parashikon edhe “Programet e ndërhyrjes për kryerësit e dhunës dhe dënimet alternative”, duke e bërë të qartë se dënimet alternative “duhet të shqiptohen vetëm pas një vlerësimi për të siguruar që nuk do të ketë rrezik për sigurinë e të mbijetuarit” (OKB 2010). Këto iniciativa e përgatitën terrenin që një nen specifik për programet për kryerësit e dhunës të përfshihet në Konventën e Stambollit, siç tregohet në dokumentet mbi punimet paraprake nga Komiteti Ad Hoc për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CAHVIO)⁵. Që nga takimi i tij i parë, Komiteti deklaroi rëndësinë e “rolit të burrave si rol model për t’u ndjekur në adoptimin e sjelljeve jo të dhunshme dhe promovimin e barazisë gjinore”⁶. Gjatë takimit të tij të dytë, CAHVIO ra dakord se “konventa e ardhshme mund të theksojë kështu rëndësinë e këtyre programeve për parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe promovimin e zbatimit të tyre”⁷.

2.2 Neni 16 i Konventës së Stambollit

Në kuadër të pjesës mbi “Parandalimin” (Kapitulli III), Neni 16 i Konventës së Stambollit kërkon që shtetet palë të krijojnë sistematikisht “programe të ndërhyrjes parandaluese dhe të trajtimit”, me qasje gjinore dhe në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të grave. Sipas kësaj dispozite, palët në konventë:

1 [...] të marrin masa legjislative ose të tjera të nevojshme për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë të mësojnë kryerësit e dhunës në familje të adoptojnë sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndër-personale me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme.

2 [...] të marrin masa legjislative ose të tjera të nevojshme për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë parandalimin e kryerësve të dhunës, në veçanti të kryesve të dhunës seksuale, që të mos kryejnë shkelje sërish.

3 [...] të sigurojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e njeriut të viktimave janë shqetësimi kryesor dhe se, kur është e përshtatshme, këto programe krijohen dhe zbatohen në koordinim të ngushtë me shërbimet e specializuara të mbështetjes për viktimat.

Neni 16 kërkon zbatimin e programeve të trajtimit për kryerësit e dhunës, me qëllim të “ndihmës për kryerësit e dhunës për t’i ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet e tyre për të parandaluar akte të mëtejshme të dhunës në familje dhe dhunës seksuale”⁸. Neni u referohet posaçërisht dy llojeve të kryerësve të dhunës: kryerësve të dhunës në familje dhe kryerësve të dhunës seksuale.

Programet që synojnë kryerësit e dhunës në familje

Sipas konventës (Neni 3, para. b), dhuna në familje përfshin “të gjitha veprimet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis ish-bashkëshortëve ose bashkëshortëve apo partnerëve aktualë, pavarësisht nëse kryerësi i dhunës është apo jo në të njëjtën banesë me viktimën”. Raporti Shpjegues i konventës (para. 103 dhe 104) sqaron më tej se shtetet palë duhet të “krijojnë ose mbështesin krijimin e programeve, kur ato nuk ekzistojnë, ose të mbështesin ndonjë program ekzistues”, qoftë i urdhëruar nga gjykata ose i detyrueshëm. Raporti pranon që shumë modele të ndryshme janë në dispozicion dhe tregojnë disa elemente thelbësore që duhet të respektohen gjithmonë.

Sipas Konventës së Stambollit, programet e kryerësve të dhunës duhet të bazohen në të kuptuar gjinor të dhunës dhe nuk duhet të konsiderohen si alternativë ndaj procedurave penale. Shtetet palë inkurajohen të zbatojnë standarde minimale uniforme që synojnë t’i japin prioritet sigurisë së grave dhe fëmijëve. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, programet për kryerësit e dhunës duhet të inkurajojnë fillimisht pjesëmarrësit të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të shqyrtojnë qëndrimet dhe bindjet e tyre ndaj grave.

5 CAHVIO, Raporti i Takimit të Parë CAHVIO (2009) 5, para. 17: “Programet për shkelësit e dhunshëm: Programet e tilla të ndërhyrjes janë zhvilluar në disa shtete anëtare viteve të fundit me qëllim që, përmes terapisë individuale ose në grup, të vendosin kryerësit e dhunës së tillë në pozicion për të kuptuar atë që kanë bërë dhe për të pranuar përgjegjësinë e tyre”. Shih edhe CAHVIO, Raporti i Takimit të Dytë CAHVIO (2009) 31, para. 8.

6 CAHVIO, Raporti i Takimit të Parë CAHVIO (2009) 5, para. 17.

7 CAHVIO, Raporti i Takimit të Dytë CAHVIO (2009) 31, para. 24.

8 Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje Stambollit (2011), para. 102.

Shtetet palë duhet së pari të sigurojnë trajnimin e duhur të profesionistëve, veçanërisht në lidhje me të kuptuarit e tyre për dhunën në familje. Profesionistët gjithashtu duhet të “posedojnë shkathhtësi të nevojshme kulturore dhe gjuhësore për t’u mundësuar atyre të punojnë me një larmi të gjerë burrash që ndjekin programe të tilla”. Vendosja e bashkëpunimit të ngushtë midis programeve për kryerësit e dhunës dhe subjekteve të tjera, të tilla si “shërbimet e mbështetjes së grave, agjencitë e zbatimit të ligjit, gjyqësori, shërbimet sprovuese dhe mbrojtja e fëmijëve ose zyrat për mirëqenie të fëmijëve” është treguar e rëndësishme thelbësore. Shtetet palë janë të mirëpritura të adoptojnë qasje të ndryshme për sa kohë që programet i japin prioritet sigurisë së viktimave: në këtë drejtim, Raporti Shpjegues paralajmëron me kujdes për rreziqet që pjesëmarrja e kryesve në këto programe mund të ndikojë në “vendimet e viktimës për të qëndruar me abuzuesin ose për ta braktisur atë”.

Programet që synojnë kryerësit e sulmeve seksuale dhe përdhunimeve

Sipas Nenit 16 të konventës, paragrafi b, shtetet palë janë të detyruara të krijojnë programe “të dizajnuara posaçërisht për të trajtuar kryerësit e dënuar të të dhunës seksuale brenda dhe jashtë burgut”. Objektivat kryesore të këtyre programeve janë “minimizimi i recidivizmit, [...] parandalimi i përsëritjes së shkeljes dhe ri-integrimi me sukses i kryerësve të dhunës në komunitet”⁹. Raporti ua lë palëve dhe/ose ofruesve të shërbimeve mundësinë e zgjedhjes midis mënyrave të ndryshme dhe kujton ekzistencën e disa modeleve të zbatuara në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

2.3 Neni 16 në Raportet e GREVIO-s

Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) është organi i paruar ekspertëve përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit nga shtetet palë¹⁰. Në vitin 2016, Komiteti nisi procedurën e tij të parë të vlerësimit në bazë të një pyetësori bazë mbi masat legjislative dhe të tjera që u japin efekt dispozitave të Konventës.

Deri më tani, GREVIO ka publikuar 17 raporte vlerësimi bazë të ndërtuara mbi informacionin e siguruar nga autoritetet kombëtare dhe palët e tjerë kombëtare të interesit, përfshirë shoqërinë civile, dhe të mbledhura gjatë vizitave në vend. Raportet përfshijnë Shqipërinë, Andorrën, Austrinë, Belgjikën Danimarkën, Finlandën, Francën, Italinë, Maltën, Monakon, Malin e Zi, Holandën, Portugalinë, Serbinë, Spanjën, Suedinë dhe Turqinë. Cikli i vazhdueshëm i monitorimit po tregon një gamë të gjerë praktikash ndërmjet shteteve palë, si në lidhje me legjislacionin dhe zbatimin praktik.

Nga trupi i raporteve të vlerësimit të publikuara deri më tani, një numër çështjesh janë identifikuar nga GREVIO në lidhje me zbatimin korrekt të Nenit 16, si në lidhje me programet për kryerësit e dhunës në familje dhe për kryerësit e dhunës seksuale. Kapitulli 4 i këtij studimi do të evokojë shembuj konkret të praktikave të vëzhguara nga GREVIO në vendet që i janë nënshtruar procedurës së vlerësimit. Shembuj nga kontekste të ndryshme kombëtare do të mundësojnë të kuptuarit më të mirë se si të zbatohen në të vërtetë dispozitat e Konventës së Stambollit, veçanërisht në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës në familje.

2.4 Standardet dhe udhëzimet e cilësisë për punën me kryerësit e dhunës

Lidhur me standardet për praktikë, dy dokumente referimi janë veçanërisht të rëndësishme. Në radhë të parë, standardet minimale të Këshillit të Evropës për shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave përfshijnë një seksion specifik mbi programet e kryerësve të dhunës brenda kapitullit për “Shërbimet e dhunës në familje” (Këshilli i Evropës 2008, 18-19). Manuali gjithashtu detajon standardet minimale dhe aspirueset specifike të shërbimit për punën me kryerësit e dhunës në familje (Këshilli i Evropës 2008, 57-58).

Në radhë të dytë, së fundmi Rrjeti Evropian i Punës me Kryerësit e Dhunës ka dhënë kontribut të rëndësishëm drejt definimit të udhëzimeve. Pas hyrjes në fuqi të Konventës së Stambollit në vitin 2014, WWP EN është angazhuar aktivisht në “zhvillimin, rishikimin dhe azhurnimin e udhëzimeve dhe standardeve të praktikës më të mirë të bazuar në prova për ndërhyrje”, me qëllim të “promovimit që programet të zhvillohen në përputhje me këto standarde”¹¹. E themeluar në vitin 2014, WWP EN lidh sot 64 anëtarë në të gjithë 32 vendet evropiane,

9 Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje Stamboll (2011), para. 105.

10 Shih uebsajtin zyrtar të GREVIO-s në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/grevio>

11 Shih uebsajtin zyrtar të WWP EN, “Qëllimet e Rrjetit”, në: <https://www.work-with-perpetators.eu/about-us/network-aims>

përfshirë programet për kryerësit e dhunës, hulumtuesit dhe shërbimet e mbështetjes së viktimave. Bazuar në dispozitat e Konventës së Stambollit, në vitin 2018 rrjeti ka zhvilluar udhëzime specifike që përcaktojnë parimet kryesore dhe çështjet prioritare për punën me autorët e kryerësit e dhunës, në mënyrë që të sigurojnë kryesisht sigurinë e viktimave. Për më tepër, WWP EN publikon rregullisht “dokumente ekspertësh” që përqendrohen në aspekte¹² specifike dhe çdo vit mban takimin e vet vjetor, duke promovuar konferenca tematike ku organizatat anëtare mund të diskutojnë çështje aktuale ose të diskutueshme në këtë fushë të punës.

12 Shih uebsajtin zyrtar të WWP EN, “Burimet”, në: <https://www.work-with-perpetators.eu/resources/expert-essays>

3. Historia e Kosovës*

3.1 Konteksti vendor

Gjatë dy dekadave të fundit, Kosova* ka arritur progres të dukshëm në shumë fusha që lidhen me qeverisjen demokratike, sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore. Sidoqoftë, pavarësisht nga reformat e fundit, Kosova* sot ende është një shoqëri shumë e pabarabartë, e shënuar me diskriminime për sa i përket gjinisë (RrGK 2018).

Në Kosovë*, rreth 62% e popullsisë jeton në zona rurale dhe varfëria është e përhapur, ku gratë përjetojnë nivele më të larta të varfërisë sesa burrat (KAS 2019a). Papunësia dhe joaktiviteti i tregut të punës vazhdojnë të jenë ndër problemet më serioze në vend. Gratë përbëjnë shumicën e popullsisë ekonomikisht joaktive, me 78.9% të grave që janë joaktive krahasuar me 40.3% të burrave, duke rezultuar në varësi ekonomike të grave nga bashkëshortët e tyre ose nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes (KAS 2019b). Në vitin 2007, niveli i analfabetizimit në mesin e grave ishte më shumë se dyfishi i burrave, me dallime relevante midis zonave urbane dhe rurale (Kelmendi 2015)¹³. Të dhënat më të fundit nga Ministria e Arsimit kanë treguar se vajzat dhe djemtë përfaqësohen sot proporcionalisht në arsimin para-universitar (MASHT 2019). Sidoqoftë, vajzat mbeten të nën-përfaqësuara në shkollat profesionale (41%) ndërsa djemtë në gjimnaze të arsimit të përgjithshëm (41.6%), gjë që konfirmon se zgjedhjet arsimore merren shpesh në bazë të pikëpamjeve stereotipike mbi atë që është më e përshtatshme për burrat ose për gratë (CSSSD 2019). Programi aktual i Kosovës* për Barazi Gjinore ka identifikuar pabarazitë strukturore socio-ekonomike midis grave dhe burrave ndër pengesat kryesore për qasjen e plotë të grave në të drejtat e tyre (ABGJ 2020)¹⁴. Për më tepër, gratë janë të nën-përfaqësuara në disa fusha të jetës publike socio-kulturore dhe institucionale (ABGJ 2020).

Historikisht, zakonet patriarkale dhe besimet e përhapura rreth roleve gjinore kanë kufizuar të drejtat e grave (Pawlak *et al.* 2016). Përkundër përparimeve të shpejta, madje edhe në Kosovën* bashkëkohore, midis sektorëve të mëdhenj të popullatës, rolet specifike janë të destinuara në mënyrë rigoroze për burrat dhe të tjerat për gratë (USAID 2018, OSBE/UNFPA 2018). Megjithëse kjo është më pak e dukshme në mesin e familjeve me nivel më të lartë arsimor, në përgjithësi burrat pritet të jenë mbajtësit e familjes dhe kryefamiljarët, ndërsa gratë kryesisht kanë për qëllim të marrin përsipër punën e papaguar shtëpiake dhe rritjen e fëmijëve.

3.2 Barazia gjinore dhe dhuna ndaj grave: një perspektivë historike

Me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve, në njëzet vitet e fundit, shoqëria civile dhe organizatat e grave kanë shtyrë barazinë gjinore në agjendën qeveritare. Me ligjin e parë për barazinë gjinore (2004), autoritetet në Kosovë* kanë ndërmarrë masa të rëndësishme për të tejkaluar diskriminimin, duke rezultuar në zhvillim të shpejtë të një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe politike për promovimin e të drejtave të grave, me fokus specifik kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave (KEDNG) është reflektuar në Nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës* të miratuar në maj 2008¹⁵. Në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës* e miratoi "Paketën e

13 Në zonat urbane, shkalla e analfabetizimit të grave është 7.5% ndërsa e burrave 3.3%; në zonat rurale ky raport mund të arrijë në 11.3% për gratë kundrejt 5.5% për burrat.

14 Për sa i përket Fuqizimit Ekonomik dhe Mirëqenies Sociale, faktorët ndikues përfshijnë: "mungesa e integritit gjinor në strategjitë dhe politikat e zhvillimit; moszbatimi i buxhetimit të përgjeshëm gjinor; diskriminimi në punësim; niveli i ulët i arsimit të grave në moshë pune (15-64); ndarja gjinore në punë; ndarja e pabarabartë e përgjegjësisë të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar; pjesëmarrje e ulët e grave në menaxhimin e burimeve; mungesa e institucioneve të kujdesit ndaj fëmijëve; dhe qasja e kufizuar në pronë dhe financa" (ABGJ 2020, 9).

15 Kuvendi i Kosovës*, Kushtetuta e Kosovës*, 2008, në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Ligjeve për të Drejtat e Njeriut”, e cila kuptonte legjislacionin e ri për barazinë gjinore, për ndalimin e diskriminimit dhe një Ligj të ri për Avokatin e Popullit (OSBE/UNFPA 2018)¹⁶. Që nga miratimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe i Planit të Veprimit në vitin 2016, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Konventa e Stambollit konsiderohet referencë dhe udhëzues për të ndërmarrë veprime (MD 2016, 14). Në vitin 2019, Kodi Penal u modifikua dhe dhuna në familje u bë vepër penale¹⁷. Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Kosovës* unanimisht vendosi të ndryshojë Kushtetutën për të bërë Konventën e Stambollit¹⁸ një nga instrumentet juridike ndërkombëtare të zbatueshëm drejtpërdrejt për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë viteve, disa mekanizma institucionalë janë ngritur për të rritur barazinë gjinore dhe për të mbështetur integritimin gjinor. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) u themelua në vitin 2006 nën Zyrën e Kryeministrit, ndërsa të gjitha ministritë dhe komunat kanë caktuar zyrtarë të barazisë gjinore. Ndër përgjegjësit e saj, ABGJ-ja ka për detyrë të koordinojë hartimin e Programit të Kosovës* për Barazi Gjinore, të monitorojë zbatimin e tij dhe t’i raportojë Qeverisë çdo vit. Për pjesën e saj, Qeveria do të shqyrtojë dhe miratojë Programin, t’i raportojë çdo vit Kuvendit për zbatimin e tij dhe të publikojë raporte periodike (ABGJ 2020). Programi i parë i Kosovës* për Barazi Gjinore (2008-2013) u aprovua në vitin 2008.

Ministria e Drejtësisë gjithashtu luan një rol vendimtar në përcaktimin e politikave që lidhen me dhunën në familje. Që nga viti 2012¹⁹, çdo Zëvendësministër i Drejtësisë duhet të marrë automatikisht rolin e Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, i cili merret me grupin ndërministror të punës për dhunën në familje, monitoron dhe zbaton Strategjinë për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe koordinon zbatimin e të gjitha politikave mbi dhunën në familje, përfshirë Procedurat Standarde të Veprimit.

Studimi i parë sasior i kryer nga Rrjeti i Grave të Kosovës vlerësoi se 46% e grave kishin pësuar dhunë në familje të paktën një herë në jetën e tyre dhe se në 91% të të gjitha rasteve të dhunës në familje autori ishte burrë (Farnsworth dhe Qosaj-Mustafa 2008)²⁰. Përveç niveleve të larta të prevalencës, një studim cilësor i bazuar në intervista të thelluara me viktimat gra dhe profesionistë tregoi nivele të gjera të pranimit të dhunës fizike, seksuale dhe ekonomike në marrëdhëniet intime (RrGK 2008). Këto gjetje të hulumtimit informuan Planin e parë Kombëtar të Veprimit të Kosovës* kundër Dhunës në Familje (2011-2014) i filluar në vitin 2011. Programi i Kosovës* dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje gjithashtu mundësoi zhvillimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (PSV), miratuar në vitin 2013. PSV-të janë dokument i politikës qeveritare që përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të përfshira, me qëllim arritjen e bashkëpunimit efektiv ndër-institucional në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (ABGJ 2019)²¹. Në vitin 2016, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2016-2020) parashikoi krijimin në nivelin lokal të mekanizmave të koordinimit komunal për mbrojtjen nga dhuna në familje, përmes institucionit të Zyrtarëve Komunalë për Barazi Gjinore (ZKGJ) dhe nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) midis disa aktorëve (MD 2016)²². Sidoqoftë, deri më sot vetëm 17 nga 38 komuna kanë krijuar mekanizma lokalë të koordinimit ndërmjet palëve relevante të interesit në adresimin e rasteve të dhunës në familje (OSBE 2019a). Përveç përmirësimeve të arritura, zbatimi aktual i legjislacionit ende përballet me sfida të shumta.

3.3 Situata aktuale dhe përhapja e dhunës në familje në Kosovë*

Pavarësisht nga ndryshimet e rëndësishme në aspektin e reformave legjislative dhe kornizave të politikave të miratuara që nga përfundimi i konfliktit, disa forma të dhunës ndaj grave vazhdojnë të jenë të përhapura dhe të raportuara më pak në Kosovë*, ku shoqëria ende mban shenjat e luftës. Rreth 73% e grave konsiderojnë se

16 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, në: https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO_05_L-020_ON_GENDER_EQUALITY.pdf, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në: https://equineteurope.org/wp-content/uploads/2019/10/Annex-LAW_NO_05_L-021_ON_THE_PROTECTION_FROM_DISCRIMINATION.pdf; Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në: [link https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922).

17 Kodi i ri Penal i Kosovës* hyri në fuqi më 14 prill 2019, në bazë të Vendimit Nr. A, Nr. 213/17, Këshilli Prokurorial i Kosovës* dhe Prokurori i Shtetit, në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>

18 Këshilli i Evropës, “Kuvendi i Kosovës* vendos të zbatojë Konventën e Stambollit”, 25 nëntor 2020, në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/vendimi-kombetar-i-vendoset-per-te-zbatuar-konventen-istanbul>

19 Qeveria e Kosovës*, Vendimi i Qeverisë së Kosovës* dhe Termit e Referencës për Emërimin e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje, 11 korrik 2012, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_83.pdf

20 Studimi u mbështet nga Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Nisma për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Grave (WSSI); Janë intervistuar 1,256 gra dhe burra.

21 Ky sistem i koordinuar përbëhet, ndër të tjera, nga përfaqësues nga Policia e Kosovës, Gjyqtarë, Prokurorë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Qendrat për Punë Sociale (QPS), Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Avokati i Popullit si dhe organizatat e shoqërisë civile, strehimoret dhe mbështetësit e partnerëve joqeveritarë (OSBE 2019a).

22 Lista e aktorëve të përfshirë përfshin kryetarë komunalash, Policinë e Kosovës, Avokatë të Viktimave (AV), Prokuroritë Themelore, Gjykatat Themelore, Departamentet Komunale të Arsimit dhe Shëndetësisë, njësinë për të drejtat e njeriut, Shërbimin Korrektues, Qendrën e Trajnimit Profesional, Zyrën e Punësimit, Zyrën e Ndihmës Juridike Falas, Qendrën për Punë Sociale dhe strehimoret.

konflikti i armatosur ndikoi drejtpërdrejt në përvojën e tyre personale të dhunës, duke shtuar forma të tjera të vuajtjeve të krijuara nga pasiguria politike dhe ekonomike dhe nga trauma psikologjike (OSBE 2019a).

Pas studimit të vitit 2008 *Siguria fillon në shtëpi* (Farnsworth dhe Qosaj-Mustafa 2008), në vitin 2014 Rrjeti i Grave të Kosovës zhvilloi një studim të dytë të prevalencës mbi dhunën në familje. Anketa vlerësoi se 41% e grave pësuan një formë të dhunës në familje, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike. Në përgjithësi, 62% e kosovarëve (68% e grave dhe 56% e burrave) thanë se kishin pësuar një formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre. Rritja prej 13 pikë në përqindje, nëse krahasohet me vitin 2008 (43%), sugjeron nivele më të larta të vetëdijes dhe më shumë gatishmëri për të folur rreth çështjes. Anketa gjithashtu tregon se dhuna në familje është përhapur në mënyrë të ngjajshme në zonat rurale dhe urbane, midis klasave të ndryshme shoqërore dhe me niveleve të ndryshme arsimore (RrGK 2015). Fenomeni është aq i zakonshëm sa vetëm rreth 14% e mjekëve të përgjithshëm të intervistuar deklarojnë se nuk janë marrë ndonjëherë me ndonjë rast të dhunës në familje gjatë gjithë karrierës së tyre (ABGJ 2019, 148).

Në vitin 2016, 1,038 raste të dhunës në familje janë raportuar tek policia e Kosovës (Morina, 2019). Më shumë se 80% e viktimave ishin gra, pastaj fëmijë dhe burra të moshuar. Në Kosovë* të gjitha këto grupe janë tradicionalisht të varura nga anëtarët e tjerë të familjes dhe ato janë më të ekspozuara ndaj dhunës në familje, e cila shpesh shkaktohet nga ofruesi ekonomik i familjes, zakonisht burri, babai ose djali i viktimës (MD 2016)²³. Varësia ekonomike, e shoqëruar me qëndrimet që fajësojnë viktimat dhe me mungesën e besimit në përgjigjen institucionale, është ndër shpjegimet kryesore të niveleve të ulëta të raportimit (RrGK 2015). Besimet e përhapura se dhuna në familje mbetet çështje private gjithashtu kontribuojnë në numrin e pakët të deklaratave në polici (Morina 2019). Sidoqoftë, që nga viti 2017, rastet e raportuara të dhunës në familje janë rritur çdo vit duke arritur në 1,915 raste në vitin 2019²⁴, një trend që mund të jetë tregues i tolerancës më të ulët shoqërore ndaj dhunës në familje dhe besimit më të lartë në institucionet gjyqësore.

Ashtu si vendet e tjera, gjatë pandemisë COVID-19 Kosova* ka regjistruar një rritje të rasteve të dhunës në familje²⁵: të dhënat e mbledhura nga policia arritën 1,571 raste të raportuara midis janarit dhe shtatorit 2020. Megjithatë dhuna u krye kryesisht në kontekstin e marrëdhënieve intime midis partnerëve (698 raste), gjatë kësaj kohe rastet e dhunës në familje kishin të bënin edhe me baballarë (197 raste) ose nëna (124 raste) që ishin të dhunshme ndaj fëmijëve të tyre. Në përgjithësi, shumica e viktimave ishin femra (1,222 raste), ndërsa një numër më i vogël i burrave ishin të ekspozuar ndaj kësaj forme të abuzimit (374 raste). Gjatë kësaj periudhe, policia dërgoi në ndjekje penale 1,381 raste të dhunës në familje²⁶.

Janë disa faktorë që kontribuojnë në përhapjen e dhunës në familje. Ndër to, varësia ekonomike e grave dhe mundësitë e kufizuara për punësim, por edhe qëndrimet dhe besimet të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pranimin e dhunës në familje nga shoqëria.

Vlerat tradicionale mund të ndikojnë në perceptimin e abuzimit intim të grave, duke çuar në justifikimin e sjelljeve të dhunshme dhe pranimin e marrëdhënieve abuzive për shkak të frikës nga dënimi shoqëror (Kelmendi 2015). Një në çdo katër gra në Kosovë* (26%) beson se është detyrim i gruas të kryej marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e saj edhe nëse nuk ndihet se i pëlqen të bëjë, dhe pothuajse gjysma e grave (48%) besojnë se dhuna në familje është çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes (OSBE 2019a, 23). Poashtu, bindjet kulturore që thonë se "burrat duhet të jenë të fortë", së bashku me mundësi të pamjaftueshme arsimore dhe punësimi, mund t'i inkurajojnë burrat të pohojnë karakterin e tyre mashkullor duke kryer dhunë ndaj grave (RrGK 2018). Konflikti gjithashtu ka pasur ndikim te burrat e përfshirë drejtpërdrejt në luftime. Hulumtimet kanë treguar se gratë kanë më shumë gjasa të ekspozohen ndaj disa formave të dhunës - të tilla si abuzimi psikologjik, frikësimi dhe poshtërimi - kur partneri i tyre ishte një ish-luftëtar (OSBE 2019a). Gjetjet nga Anketa Ndërkombëtare mbi Burrat dhe Barazinë Gjinore kanë treguar se dhuna me bazë gjinore është normalizuar kryesisht si praktikë e ligjshme disiplinore. Hulumtimet kanë vërtetuar se pabarazia gjinore është e rrënjësuar thellë edhe në mesin e grave, të cilat kontribuojnë aktivisht në transmetimin e vlerave tradicionale: megjithatë shumica e njerëzve e dinë që sistemi gjyqësor i Kosovës* përmban dispozita ligjore mbi dhunën në familje²⁷, pothuajse gjysma e popullsisë (48% e burrave dhe 58% e grave) besojnë se ligje të tilla i ekspozojnë gratë ndaj stigmatizimit dhe dhimbjes edhe më shumë (OSBE/UNFPA 2018).

23 Burrat, në veçanti burrat e moshuar, mund të jenë gjithashtu shënjestër e dhunës, e kryer kryesisht nga anëtarët e tjerë meshkuj të familjes duke përfshirë baballarët, djemtë dhe vëllezërit (OSBE 2019a).

24 Policia regjistroi 1269 raste në vitin 2017, 1541 raste në 2018 dhe 1915 raste në 2019.

25 Prishtina Insight, "Raportet e rritjes së dhunës në familje në vitin 2020", në: <https://prishtinainsight.com/reports-of-domestic-violence-increase-in-2020/>

26 Të dhënat e siguruar nga policia në nëntor 2020. Midis 1571 rasteve të raportuara të dhunës në familje, ishin përfshirë 1596 viktimat, pasi që «një rast» mund të përfshijë disa viktimat. Sa i përket moshës së viktimës, shumica e viktimave ishin midis 20 dhe 30 vjeç (409) ose ndërmjet 30 dhe 40 vjeç (407), një përqindje më e vogël kishte të bënte me viktimat midis 50 dhe 60 vjeç (137).

27 Rreth 68% e burrave dhe 56% e grave.

Për më tepër, normat kulturore mund të ndikojnë në përgjigjen e profesionistëve ndaj dhunës në familje, përfshirë punën e agjentëve të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve, ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe punëtorëve socialë. Mungesa e të kuptuarit të dimensionit gjinor të dhunës në familje gjithashtu çon në qëndrime që fajësojnë viktimat, duke rezultuar në përpjekje për barazimin e viktimës dhe dhunuesit (RrGK 2015). Mangësitë në përgjigjen institucionale përfshijnë edhe përgjigje të pakta, bashkërendim joefikas dhe zbatim të dobët të roleve dhe përgjegjësive të parashikuara në PSV-të nga Policia e Kosovës*, Qendrat për Punë Sociale dhe palët e tjera të përfshira, përfshirë shërbimet e prokurorisë (Qosaj-Mustafa dhe Morina 2018).

Programi i lansuar së fundmi i Programit të Kosovës* për Barazi Gjinore (2020-2024) pranon që në Kosovë*, koordinimi, bashkëpunimi ndërinstitutional dhe menaxhimi i rrezikut janë ende joadekuate (ABGJ 2019). PKBGj-ja identifikon disa çështje që pengojnë të drejtat e grave dhe qasjen e grave në drejtësi dhe siguri, siç është mungesa e një mekanizmi përcjellës për monitorimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore; shtyrja në zbatimin dhe dhënien e urdhrave të mbrojtjes në rastet e dhunës në familje; shqiptimi i ndëshkimeve të lehta nga gjykatat ose madje edhe pa ndëshkime fare në rastet e dhunës në familje; mungesa e programeve për trajtimin psikosocial të kryerësve të dhunës dhe për ri-integrimin e viktimave të dhunës në familje (ABGJ 2020, 10). Qëllimi kryesor për programin e ardhshëm katër-vjeçar është të sigurojë që barazia gjinore të vendoset në qendër të proceseve të transformimit në Kosovë*, duke përfshirë të gjitha agjencitë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe komunitetin e donatorëve. PKBGj-ja gjithashtu pranon që iniciativat që synojnë kryerësit e dhunës në familje janë të pamjaftueshme, pavarësisht që legjislacioni sekondar parashikon masa të trajtimit psikosocial. Ndërsa ndihma për gratë viktime të dhunës në familje është përmirësuar me kalimin e viteve, duhet bërë shumë në lidhje me rehabilitimin dhe ri-integrimin e kryerësve (ABGJ 2020, 56). Për momentin, PKBGj-ja nuk përfshin ndonjë veprim specifik në këtë fushë.

4. Programet e kryerësve të dhunës në Kosovë*

Në Kosovë, kryerësit e dhunës ose shkojnë në burg ose trajtohen si psikopatë*

Zyrtari i organizatës ndërkombëtare

Kryerësit e dhunës janë qenie njerëzore.

Ai mund të jetë babai, vëllai, dikush i afërt.

Ne flasim vetëm për viktimat, por kryerësit e dhunës nuk do të ndryshojnë nëse nuk punojmë me ta.

Të gjithë duhet të përfshihen.

Psikiatër

4.1 Masat ligjore dhe të politikave që synojnë kryerësit e dhunës në familje

Në vitin 2011, Programi i parë i Kosovës* dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje (2011-2014) tashmë parashikonte krijimin e "Aktiviteteve të Mbështetjes, Trajtimit dhe Ri-integritimit" për kryerësit e dhunës në familje, me qëllim të "gjetjes së mënyrave për të ndihmuar kryerësit e dhunës që ata të integrohen plotësisht në shoqëri" (MD 2015, 11). Prandaj, Objektivi Specifik 3 në lidhje me "Shërbimet" përfshinte ndërtimin dhe forcimin e shërbimeve sociale si për viktimat, ashtu edhe për kryerësit e dhunës në familje. Që nga ajo kohë, u miratuan dy udhëzime administrative që synojnë kryerësit e dhunës: Udhëzimi Administrativ nr. 12/2012, për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje dhe Udhëzimi Administrativ nr. 02/2013, që ofron indikacione mbi trajtimin e detyrueshëm mjekësor për shkelësit të varur nga alkooli dhe droga²⁸. Këto akte nënligjore gjithashtu bënë thirrje për krijimin e OJQ-ve të certifikuara dhe/ose agjencive qeveritare që ofrojnë trajtim të detyrueshëm të urdhëruar nga gjykata për kryerësit e dhunës duke zhvilluar infrastrukturën e duhur në nivelin komunal²⁹.

Në vitin 2015, vlerësimi i zbatimit të Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit (2011-2014) raportoi se miratimi i këtyre dy udhëzimeve administrative kishte mbetur i kufizuar në praktikë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, për shkak të "një mungese të plotë të infrastrukturës" (MD 2015, 17). Për t'iu përgjigjur këtij zbatimi minimal, vlerësimi rekomandoi që të alokohen fondet e nevojshme dhe/ose infrastruktura dhe të përfshihet aktiviteti në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit të ardhshëm kundër Dhunës në Familje (2016-2020). Strategjia e miratuar në vitin 2016 konfirmoi kështu nevojën për të krijuar programe për kryerësit e dhunës në përputhje me Konventën e Stambollit, së bashku me zbatimin e masave të përshtatshme ndëshkuese. Në Strategji, shërbimet ekzistuese të konsultimit dhe programet e trajtimit për kryerësit e dhunës në familje konsiderohen "të pamjaftueshme" (MD 2016, 32). Duke renditur "Rehabilitimin dhe Ri-integrimin" midis prioriteteve dhe sfidave kryesore për periudhën, autoritetet lokale pritën

28 Masa të tilla ishin treguar tashmë në nenin 4 dhe 9 të Ligjit për Mbrojtjen e Dhunës në Familje, që të jenë çështje në kombinim me masat e tjera mbrojtëse të parashikuara me ligj. Shih Qosaj-Mustafa dhe Morina (2018, 38).

29 Shih nenin 8, paragrafin 3 të UA-së Nr. 12/2012, cituar në MD (2015, 17).

të krijojnë deri në vitin 2020 “programe të detyrueshme dhe efikase për rehabilitimin e kryerësve të dhunës, të ofruara nga institucione të specializuara” (MD 2016, 42). Plani i veprimit gjithashtu ofroi indikacione të hollësishme mbi veprimet specifike, burimet financiare, institucionet partnere dhe rezultatet e pritura për secilin objektiv. Programi i Kosovës* për Barazi Gjinore (2020-2024), i nisur në qershor 2020, përmend edhe një herë mungesën e iniciativave që synojnë trajtimin psikosocial të kryerësve të dhunës midis sfidave urgjente që duhet të adresohen për periudhën e ardhshme katër-vjeçare (ABGJ 2020).

Edhe pse nevoja për të krijuar programe që synojnë kryerësit e dhunës në familje është përmendur vazhdimisht në dokumentet e politikave që nga viti 2012, analiza e mëparshme ka zbuluar se programet për kryerësit e dhunës, siç përcaktohet nga Konventa e Stambollit, nuk ekzistojnë në Kosovë* (KiE 2017). Në të njëjtën linjë, shumica e bashkëbiseduesve të kontaktuar për këtë hulumtim pohuan se “asgjë nuk është bërë në Kosovë*” në lidhje me këtë. Sidoqoftë, ky studim ka identifikuar dy nisma që synojnë kryerësit e dhunës në familje dhe ka vlerësuar zbatimin real të masave ligjore dhe të politikave që synojnë këtë popullatë.

4.2 Praktikat eksperimentale për trajtimin e kryerësve të dhunës

Kjo pjesë e parë e kapitullit do të përshkruajë dy nisma eksperimentale: projektin pilot të filluar nga Shtëpia e Sigurt në Komunën e Gjakovës dhe programin e krijuar nga Qendra Sit në Prishtinë. Këto dy programe janë përjashtime të izoluara në skenën lokale, dhe vetëm disa të anketuar kishin dëgjuar për to. Megjithatë ato shpijnë drejt kërkesave të vendosura nga standardet ndërkombëtare, këto janë ende përvoja të bazuara në projekt, jo të financuara sistematikisht dhe të ndara nga një sistem uniform dhe i harmonizuar. Origjina dhe funksionimi i këtyre dy iniciativave do të ilustron këtu, ndërsa disa aspekte specifike do të diskutohen më tej, në analizën e hollësishme të zbatimit real të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën*.

Shtëpia e Sigurt në Gjakovë

E themeluar në Gjakovë në vitin 1999, “Shtëpia e Sigurt” është një nga strehimoret më të vjetra në Kosovë* dhe ndër të parat që është licensuar (OSBE 2019a). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka akredituar punën e saj në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe gjatë viteve ka fituar njohje për punën e saj me gratë viktime të dhunës në familje. Sot Shtëpia e Sigurt është anëtare e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe një pjesë e rëndësishme e mekanizmit të koordinimit në Komunën e Gjakovës. Gjykata, policia, shërbimi sprovues dhe Shtëpia e Sigurt janë pjesë e mekanizmit lokal të koordinimit, i cili duket shumë aktiv në ofrimin e një përgjigje të harmonizuar kundër dhunës ndaj grave. Në veçanti, dy gjykatës i janë përkushtuar posaçërisht rasteve të dhunës në familje dhe kanë mbështetur vazhdimisht strehimoren me këshilla ligjore. Që nga viti 2018, edhe shërbimi lokal sprovues ka filluar të punojë në bashkëpunim me Shtëpinë e Sigurt.

Siç përcaktohet nga neni 4 i Udhëzimit Administrativ 12/2012, strehimoret - si dhe institucionet e tjera “me ekspertizë në këtë fushë” - mund të sigurojnë trajtim psikosocial për kryerësit e dhunës në familje³⁰. Gjatë më shumë se njëzet viteve të përvojës në mbështetjen e grave viktime, personeli i strehimores ka vërejtur nivele të larta të mosdëshkimit për kryerësit e dhunës dhe në të njëjtën kohë ka pranuar kufijtë e një qasje ndëshkuese ndaj abuzuesve në familje. Në vitin 2019, Shtëpia e Sigurt nisi një projekt pilot të financuar nga Ambasada Norvegjeze në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile, me qëllim që të marrin trajnim specifik për trajtimin e abuzuesve në familje. Trajnimi u siguroi nga organizata Total Family Coaching, me qendër në MB. Organizata merret kryesisht me konflikte familjare dhe trauma dhe ofron “Programin e Lirisë”, një kurrikulë trajnimit që synon të punojë me burra kryerës të dhunës së bashku me gra dhe fëmijë viktime të dhunës në familje³¹. Pas seancave të trajnimit, një grup profesionistësh femra nga Shtëpia e Sigurt, së bashku me një student mashkull në psikologji, filluan një program eksperimental për kryerësit e dhunës.

Në bazë të vendimit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, e cila gjithashtu mbulon komunitat e Rahovecit dhe Malishevës, kryerësit e dhunës të dënuar me masa alternative janë referuar në zyrën lokale të shërbimit kombëtar sprovues, e cila nga ana tjetër ridrejton rastet që kërkojnë mbikëqyrje dhe trajtim të detyrueshëm psikologjik në Shtëpinë e Sigurt Sapo të përfundojnë seancat e këshillimit, profesionistët duhet të plotësojnë një raport dhe përfundimisht të përfshijnë rekomandime specifike për shërbimin sprovues. Raporti pastaj shtohet në dosjen e rastit të kryerësit të dhunës dhe dërgohet përsëri në Gjykatë. Sipas informacionit të ofruar

30 Neni 4 «Vendi i kryerjes së trajtimit psikosocial», paragrafi 1, përmend institucionet shëndetësore, institucionet sociale dhe organizatat joqeveritare që kanë ekspertizë në këtë fushë dhe me këtë popullatë.

31 Më shumë informata gjenden në: www.totalfamilycoaching.co.uk. Informacioni mbi iniciativat e zhvilluara në Kosovë* mund të gjenden në: <https://www.totalfamilycoaching.co.uk/volunteering-in-kosovo>. Nuk është e qartë nëse një vlerësim i rrezikut është realizuar para se të përfshihen gra dhe fëmijë.

nga zyrtari lokal i shërbimit sprovues, së shpejti do të nënshkruhet një marrëveshje zyrtare në mënyrë që të mundësojë referimin sistematik të kryerësve të dhunës tek Shtëpia e Sigurt, si dhe aranzhimet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës për referimin e kryerësve të dhunës të dënuar me masa alternative.

Në vitin 2019, gjatë një periudhe prej nëntë muajsh, gjashtë burra morën pjesë në një program të bazuar në takime individuale dhe punë në grupe. Shumica e tyre ishin kryerës të dhunës në familje pa ndonjë problem specifik të shëndetit mendor ose problem të varësisë, ndërsa dy burra u referuan në shërbime të specializuara shëndetësore pas një vlerësimi individual. Gjatë programit pilot, takimet me kryerësit e dhunës u mbajtën në objekt të ndarë të ofruar nga rrjeti i OJQ-ve të grave "Qeliza" në Gjakovë. Një psikolog dhe këshilltar psikosocial zhvilluan çdo sesion duke përdorur një qasje kognitive të sjelljes dhe lojëra me luajtje rolesh të marra nga Modeli Duluth. Pjesëmarrësit në program pritej të identifikonin dhe rimodelonin përdorimin e tyre të pushtetit dhe taktikave të kontrollit, për ta mbajtur veten llogaridhënës për veprimet e tyre, me qëllimin kryesor të ndryshimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre ndaj gruas dhe fëmijëve. Stafi i Shtëpisë së Sigurt ka ndjerë nevojën për të përshtatur "Programin e lirisë" në kontekstin e tyre dhe përfshiu edhe disa takime me kryerësit e dhunës dhe në disa raste përfshiu anëtarët e tjerë të familjes në trajtim. Nga informacioni i dhënë, nuk është e qartë nëse takimet me partnerin dhe fëmijët ishin krijuar në bazë të një vlerësimi të mëparshëm të rrezikut. Megjithatë programi në Gjakovë nuk parashikon kontakt sistematik me viktimën, në dy raste profesionistët kërkuan përshtypjet e gruas për ndryshimet e kryesit të dhunës, në mënyrë që të monitoronin zhvillimet në sjelljen e tij. Në përgjithësi, profesionistët konsiderojnë se kanë vërejtur një rënie të konsiderueshme të sjelljeve të dhunshme.

Deri më sot, Shtëpia e Sigurt nuk ndjek ndonjë standard specifik për punën me kryerësit e dhunës. Udhëzimet e brendshme konsistojnë vetëm në listën e hapave të sugjeruar fillimisht nga trajnerët. Stafi i intervistuar ka treguar interes në zhvillimin e punës së mëtejshme me kryerësit e dhunës në familje, përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe zhvillimin e mbledhjes dhe hulumtimit të të dhënave.

Qendra Sit në Prishtinë

Qendra Sit është organizatë jo-qeveritare me seli në Prishtinë³². E themeluar në vitin 2008, aktivitetet e saj kryesore janë këshillimi, shërbimi social dhe hulumtimi. Qendra gjithashtu promovon avokim, ndërjegjësim, edukim nga bashkëmoshatarët në shkolla dhe trajnimin e profesionistëve në nivelin lokal. Që nga viti 2017, Qendra Sit integron promovimin e barazisë gjinore në marrëdhëniet ndërpersonale me parandalimin e dhunës. Në veçanti, Qendra ofron këshillim profesional për kryerësit e dhunës në familje.

Qendra Sit është organizata e vetme në Kosovë* që punon me burra në bazë të vetë-referimit, në vend të rasteve të urdhëruara nga gjykata ose kryerësve të dhunës me probleme të shëndetit mendor ose me probleme të varësisë. Stafi aktualisht është duke punuar në marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimin Korrektues dhe Sprovues dhe Policinë e Kosovës*, për të inauguruar programe të detyrueshme dhe kështu të rrisin numrin e pjesëmarrësve. Për momentin, ai ofron vetëm seanca këshillimi individual për pjesëmarrësit vullnetarë. Puna në grupe me kryerësit e dhunës nuk është zbatuar kryesisht për shkak të shqetësimeve të konfidencialitetit në lidhje me informacionin dhe të dhënat personale të kryerësve të dhunës³³. Ndër projektet e saj të ardhshme, Qendra Sit parashikon t'i nënshtrohet procesit³⁴ të licencimit që kërkohet për të punuar me kryerësit e dhunës të dënuar në kujdestari dhe të sigurojë programe mbështetëse përcjellëse për kryerësit e dhunës në familje që janë liruar nga burgju.

Sesionet aktuale të këshillimit në Qendrën Sit bazohen kryesisht në një qasje kognitive të sjelljes, e cila gjithashtu përfshin punë psiko-edukative dhe aktivitete të luajtjes së roleve. Trajtimi ka për qëllim sigurimin e udhëzimeve praktike dhe teknikave për vetë-menaxhim emocional dhe përmirësimin e shkathtësive ndërpersonale të komunikimit. Çdo seancë mbahet një herë në javë për rreth 40 minuta. Profesionistët vlerësojnë se takimet duhet të mbahen për një minimum prej 3 deri në 24 seanca, për një periudhë prej rreth gjashtë muajsh, në mënyrë që të minimizohet rreziku i recidivizmit dhe të arrihen ndryshime të qëndrueshme në qëndrimet dhe sjelljet e kryerësve të dhunës. Vlerësimet e stafit se një program përcjellës pas liritimit nga burgju do të kërkonte 10 deri në 15 seanca të detyrueshme. Në të gjitha rastet, duhet të ndahen burime financiare adekuate. Financimi duhet të mbështesë edhe mbledhjen e të dhënave, si dhe vlerësime të rregullta të efikasitetit të programit. Megjithatë shumica e klientëve të regjistruar në program janë burra, Qendra Sit pranon

32 Më shumë informata gjenden në websajtin, në: <http://www.sit-ks.org/>

33 Sipas standardeve ndërkombëtare (shih paragrafin 4.3.3.), në disa raste programet për kryerësit e dhunës mund të marrin në konsideratë kufizimin e të drejtave të konfidencialitetit të pjesëmarrësve.

34 Siç është vendosur me Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2013 "për licencimin e subjekteve juridike/organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.

edhe femra kryerëse të dhunës ndaj bashkëmoshatarëve dhe dhunës në familje. Kur merren me burra kryerës të dhunës, profesionistët rregullisht bëjnë përpjekje për të identifikuar lidhjet midis sjelljes individuale, pabarazive strukturore gjinore dhe pritjeve sociale për rolet gjinore. Sidoqoftë, nuk është e qartë se në çfarë mase programi adopton sistematikisht një perspektivë gjinore.

Gjatë viteve, profesionistët që punojnë në Qendrën Sit kanë marrë disa trajnime të ofruara nga organizata ndërkombëtare, të tilla si Programi Ndërkombëtar i Trajnimit (ITP), i cili përfshinte një specializim se si të parandalohet dhe të reagohet ndaj DHBGj-së³⁵. Kompetencat dhe njohuritë specifike se si të merren me autorët e dhunës në familje janë zhvilluar përmes pjesëmarrjes në trajnime të ofruara nga organizatat zvicerane Agredis.ch³⁶ dhe Iamaneh³⁷, të cilat mbështesin disa nisma në Ballkan. Disa punonjës të Qendrës Sit morën pjesë gjithashtu në "Trajnimin e këshilltarëve profesionistë me burra të rinj dhe djem për t'i dhënë fund dhunës", i cili u mbajt në Shqipëri në vitin 2018. Pas trajnimit, u krijua një bashkëpunim zyrtar midis Qendrës Sit dhe Linjës së Këshillimit për Burra dhe Djem si në Tiranë ashtu edhe në Shkodër, me qëllim shkëmbimit të njohurive dhe praktikave.

Në nivelin lokal, Qendra Sit ka marrë një rol aktiv në përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional, menaxhimin e rasteve dhe ndërtimin e kapaciteteve midis disa institucioneve, për të nxitur një zbatim efektiv të dispozitave ligjore ekzistuese. Qendra gjithashtu ka kërkuar që të përfshijë parandalimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e kryerësve të dhunës në mekanizmat komunalë të koordinimit. Ky përparim do të mundësonte edhe adoptimin e procedurave sistematike në kontaktimin me partneret femra të kryerësve të dhunës, në bazë të protokolleve të vendosura me strehimoret dhe shërbimet mbështetëse të grave. Për momentin, nuk është krijuar asnjë protokoll sistematik për kontaktin me viktimat.

Që nga themelimi, Qendra Sit gjithashtu mori pjesë në disa rrjete ndërkombëtare, të tilla si projekti Young Men Initiative, Men Engage dhe Men Care International, duke promovuar barazinë gjinore nga këndvështrimi i burrave. Është organizata e vetme në Kosovë* e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Punës me Kryerësit e Dhunës.

4.3 Zbatimi i përgjithshëm i programeve për kryerësit e dhunës në tërë Kosovën*

Kjo pjesë e dytë e kapitullit analizon zbatimin e përgjithshëm të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën* dhe do të përqendrohet në tri fusha tematike: (1) Qasjen në programet për kryerësit e dhunës; (2) Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimin me shërbimet mbështetëse të grave; (3) Perspektivën gjinore dhe standardet minimale për praktikë. Secila prej këtyre seksioneve së pari do të kujtojë standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe parimet udhëzuese për praktikë, pastaj do të ilustron shembuj specifik të nxjerrë nga raportet e GREVIO-s, dhe së fundi, do të vlerësojë gjendjen aktuale në Kosovë*, përfshirë boshllëqet dhe mangësitë.

Qasja në trajtimin e kryerësve të dhunës

Qasja në trajtimin e kryerësve të dhunës

- Zhvillimi i një legjislacion kombëtar që mbështet programet për kryerësit e dhunës
- Promovimi i shpërndarjes gjeografike të programeve
- Sigurimi që lloje të ndryshme të programeve të jenë në dispozicion
- Diversifikimi i rrugëve për referim në mënyrë që të sigurohen nivele më të gjera të pjesëmarrjes
- Ofrimi i fondeve adekuate

i. Standardet ndërkombëtare dhe parimet udhëzuese

Nëse zbatohen siç duhet, programet për kryerësit e dhunës mund të kontribuojnë në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna e mëtejshme. Sipas Raportit Shpjegues të Konventës së Stambollit (paragrafi 103), autoritetet kombëtare u kërkohet të "krijojnë ose mbështesin krijimin e programeve, kur ato nuk ekzistojnë, ose

35 Trajnimi u sigurua nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA) në bashkëpunim me Policinë Suedeze dhe Fondacionin Kvinna till Kvinna gjithashtu kontribuan në trajnim.

36 Për më shumë informata, webfaqja zyrtare është në dispozicion në: <https://www.agredis.ch/>

37 Për më shumë informata, webfaqja zyrtare është në dispozicion në: <https://www.iamaneh.ch/en/about-us/>

të mbështesin ndonjë program ekzistues për kryerësit e dhunës në familje”.

Shumica e ekspertëve pajtohen që sikurse programet vullnetare dhe ato të detyrueshme duhet të jenë në dispozicion. Iniciativat që synojnë kryerësit e dhunës duhet të sigurojnë seanca individuale dhe punë në grupe dhe standardet minimale duhet të zbatohen për të gjitha llojet e programeve për kryerësit e dhunës, me rregullime specifike dhe me mundësinë për të aplikuar sanksione për mos-pjesëmarrje. Puna e kryerësve të dhunës duhet të integrojnë në mënyrë të qartë qasjen kulturore dhe klinike ndaj dhunës në familje dhe lehtësuesit duhet të inkurajojnë, udhëheqin dhe promovojnë ndryshimet në pjesëmarrës. Është e një rëndësie të madhe që programet të mos përdoren si një alternativë për procedura penale (Këshilli i Evropës 2008).

ii. *Mostër praktikash nga raportet e GREVIO-s*

Në disa raporte, GREVIO ka theksuar rëndësinë e vënies në dispozicion të programeve për kryerësit e dhunës në të gjithë vendin³⁸. GREVIO ka inkurajuar zhvillimin e një kornize ligjore kombëtare në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës dhe ka theksuar rëndësinë e sigurimit të burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të garantuar qëndrueshmërinë³⁹ e programeve. Në shumë raporte, GREVIO gjithashtu ka theksuar nevojën për nivele më të gjera të pjesëmarrjes në trajtim dhe, në këtë drejtim, ka sugjeruar diversifikimin e rrugëve për referim⁴⁰. Komiteti ka theksuar se referimi në programet e kryerësve të dhunës mund të bëhet në faza të ndryshme të procedurave, përkatësisht në rastet e adoptimit të ndalimit emergjent dhe urdhrave për mbrojtje/ndalim, dhe në procedurat gjyqësore për të përcaktuar kujdestarinë e fëmijëve dhe të drejtat për vizita⁴¹. Në disa raste, GREVIO ka sugjeruar përfshirjen e programeve të tilla në sistemin e drejtësisë penale, përfshirë shërbimet sprovuese, si mjet për të zvogëluar recidivizmin⁴². Kur përballet me të dhëna për nivelet e larta të braktisjes, GREVIO ka vërejtur rëndësinë e maksimizimit të përfundimit të programeve duke punuar në motivimin e kryerësve të dhunës për të ndryshuar që nga fazat e hershme të pjesëmarrjes⁴³.

GREVIO ka theksuar që autoritetet kombëtare jo vetëm që duhet të zgjerojnë numrin e shërbimeve, por edhe llojet e shërbimeve në dispozicion⁴⁴, duke siguruar programe vullnetare dhe të detyrueshme, në mjedise kujdestarie dhe ato jo-kujdestarie⁴⁵. Sigurimi i programeve të ndryshme për kryerësit e dhunës e formave dhe shkallëve të ndryshme të abuzimit mund të kontribuojë në parandalimin e rrezikut të përshkallëzimit të dhunës⁴⁶. Për shembull, GREVIO ka mirëpritur programe që gjithashtu kanë që qëllim djemtë që më parë i ishin ekspozuar dhunës dhe kështu riprodhojnë modele të sjelljes të dhunshme⁴⁷. Meqenëse dhuna në familje shpesh është e nën-raportuar dhe në shumicën e vendeve nivelet e dënimit janë akoma të ulëta, GREVIO ka vërejtur se programet e detyrueshme arrijnë vetëm në një pakicë të kryerësve të dhunës, duke lënë jashtë një numër të konsiderueshëm burrash të dhunshëm të cilët nuk po referohen për asnjë trajtim. Në rastin e Maltës, GREVIO ka vërejtur me shqetësim se, edhe kur pjesëmarrja e detyrueshme vendoset nga gjykata, nuk merren masa nëse personi refuzon të paraqitet në program⁴⁸. Diku tjetër, Komiteti ka rekomanduar që programi i ndërrhyrjes parandaluese dhe trajtimit duhet të jetë i disponueshëm edhe në bazë të vetë-referimit⁴⁹. Kur trajtimi është i disponueshëm vetëm mbi baza vullnetare, GREVIO ka inkurajuar fuqimisht autoritetet kombëtare të marrin në konsideratë mundësinë e vendosjes së një detyrimi për të ndjekur programet⁵⁰. Përveç kësaj, është e rëndësishme që kohëzgjatja e programeve të mundësojë kohë të mjaftueshme për të nxitur një ndryshim autentik në sjelljen⁵¹ e abuzuesve.

Në ato vende ku trajtimi i kryerësve të dhunës mund të urdhërohet nga gjykata, GREVIO ka theksuar se është e një rëndësie të madhe që pjesëmarrja e detyrueshme në program të mos përdoret si alternativë ndaj procedurave penale. Pjesëmarrja e detyrueshme duhet të konceptohet si masë parandaluese përveç sanksionet pe-

38 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Itali (GREVIO/Inf(2019)18); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Francë (GREVIO/Inf(2019)16); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Spanjë (GREVIO/Inf(2020)19).

39 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Itali (GREVIO/Inf(2019)18); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Maltë (GREVIO/Inf(2020)17), para. 85.

40 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Austri (GREVIO/Inf(2017)4), paragrafët 82-87; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Danimarkë (GREVIO/Inf(2017)14), paragrafët 87-95; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Finlandë (GREVIO/Inf(2019)9), paragrafët 74-81; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Itali (GREVIO/Inf(2019)18), paragrafët 108-117.

41 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Itali (GREVIO/Inf(2019)18), para. 112.

42 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Finlandë (GREVIO/Inf(2019)9), para. 79; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Holandë (GREVIO/Inf(2019)19), para. 107.

43 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Spanjë (GREVIO/Inf(2020)19), para. 106.

44 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Portugalí (GREVIO/Inf(2018)16), para. 105.

45 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Spanjë (GREVIO/Inf(2020)19); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Maltë (GREVIO/Inf(2020)17).

46 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Danimarkë (GREVIO/Inf(2017)14), para. 88.

47 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Andorrë (GREVIO/Inf(2020)18), para. 82.

48 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Maltë (GREVIO/Inf(2020)17), para. 85.

49 Shih për shembull GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Austri (GREVIO/Inf(2017)4), paragrafët 82-87; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Turqi (GREVIO/Inf(2018)6), paragrafët 123-131; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Monako (GREVIO/Inf(2017)3), paragrafët 55-58; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Portugalí (GREVIO/Inf(2018)16), paragrafët 101-106.

50 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Itali (GREVIO/Inf(2019)18), para. 117.

51 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Francë (GREVIO/Inf(2019)16), para. 118.

nale⁵² dhe nuk duhet të zëvendësojë ndjekjen penale ose dënimin⁵³. Për shembull, në raportin për Shqipërinë, Grupi i Ekspertëve vuri në dukje prirjen e ulët të gjykatave për të adoptuar masa mbrojtëse që u kërkojnë kryerësve të dhunës të regjistrohesh në programet e rehabilitimit⁵⁴. Në vende si Belgjika dhe Spanja, ku programet e kryerësve të dhunës mund të vendosen si masa alternative ndaj burgut, GREVIO ka inkurajuar shtetet palë të përcaktojnë me saktësi se në cilat rrethana mund të ndodhë, të parashikojnë një procedurë të vlerësimit të rrezikut dhe të sigurojnë që masat alternative për kryerësit e dhunës të mos jenë të kufizuara në ndonjë formë të shërbimit komunitar⁵⁵.

Në disa vende, autoritetet kombëtare kanë përcaktuar një kornizë ligjore për zbatimin e programeve të kryerësve të dhunës dhe alokojnë rregullisht burime financiare për organizatat e shoqërisë civile të ngarkuara me udhëheqjen e shërbimeve⁵⁶. Ky është edhe rasti i Shqipërisë, ku Ligji i fundit "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare" (Ligji Nr. 966/2006) përcakton përgjegjësinë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të mbështetur dhe mbikëqyrur krijimin e qendrave të rehabilitimit për kryerësit e dhunës në familje. Ky ligj në Shqipëri përcakton edhe që autoritetet e brendshme kanë për detyrë të «ngrisin qendra sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit dhe të koordinojnë punën me ato ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse»⁵⁷.

iii. Gjendja në Kosovë*

Përkundër hapave të rëndësishëm të ndërmarrë drejt zhvillimit të një kornize ligjore dhe në favor të iniciativave që synojnë kryerësit e dhunës në familje, numri i shërbimeve për kryerësit e dhunës në dispozicion në Kosovë* duket të jetë i kufizuar dhe pjesëmarrja në programe është akoma shumë e ulët. Pas rritjes së rasteve të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19, disa bashkëbisedues kanë theksuar nevojën urgjente për të frenuar dhunën e burrave ndaj grave duke punuar drejtpërdrejt me kryerësit e dhunës në faza të ndryshme, duke filluar në fazat e hershme të sjelljes abuzive dhe kontrolluese, deri në momentin i ri-integrimit të kryerësve të dhunës në familje dhe në shoqëri pas daljes nga burgu. Rëndësia e kufizimit të pasojave të karakterit mashkullor të dëmshëm është pranuar kryesisht si prioritet institucional.

Në Kosovë* gjyqtarët e gjykatave civile mund të vendosin trajtim psikosocial deri në gjashtë muaj dhe trajtim të abuzimit të alkoolit dhe substancave deri në dy vjet, në përputhje me Udhëzimet Administrative nr. 12/2012 dhe nr. 02/2013 (Qosaj-Mustafa dhe Morina 2018). Të gjithë njerëzit e intervistuar për këtë hulumtim ranë dakord për të kritikuar kufijtë e dispozitave të tilla. Nga njëra anë, shumica e palëve të interesit kanë theksuar nevojën për të punuar me të gjithë kryerësit e dhunës në familje pasi që, në praktikë, burrat me probleme të varësisë ose me probleme të shëndetit mendor duken të vetmet kategori të kryerësve të dhunës të mbuluar nga dy udhëzimet administrative. Nga ana tjetër, disa të intervistuar kanë theksuar faktin se edhe masat ekzistuese nuk duket se po zbatohen efektivisht.

Referimi në programet e kryerësve të dhunës mund të bëhet në faza të ndryshme. Në shumë raste, Policia e Kosovës* është subjekti i parë juridik që kontaktohet nga gratë viktime dhe ajo luan rol vendimtar në marrjen e deklaratës së viktimës, mbledhjen e provave rrethore, duke bërë një vlerësim të saktë të rrezikut dhe përcaktimin e një plani efektiv të sigurisë. Në këtë proces, kryerësi i dhunës shpesh arrestohet dhe merret në paraburgim për rreth 24 orë, kohë gjatë së cilës prokurori duhet ta marrë në pyetje abuzuesin. Siç është raportuar nga disa palë të interesit, në praktikë policia shpesh e liron burrin pas disa orësh pa ndonjë hetim të duhur. Në këtë fazë të procesit, masa specifike që synojnë kryerësin e dhunës mund të merren për të parandaluar akte të reja dhune, për shembull duke kombinuar programet për kryerësit e dhunës me urdhra mbrojtjeje ose masa të tjera parandaluese, siç sugjerohet nga disa të intervistuar. Pengesat për një zbatim të saktë të urdhrave për mbrojtje përfshijnë faktin se shpesh as kryerësi i dhunës dhe as viktimat nuk kanë ku të shkojnë. Disa bashkëbisedues kanë konfirmuar se në shumë raste gratë vazhdojnë të jenë të ekspozuara ndaj dhunës edhe kur nxjerrët një urdhër mbrojtjeje dhe janë të detyruara të ndajnë të njëjtën apartament me abuzuesin (ABGJ 2019).

Në Kosovë* trajtimi i kryerësve të dhunës mund të vendoset edhe si "masë mbrojtëse" plotësuese e vendosur me një Urdhër për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme (UMEP) të nxjerrë nga policia ose nga gjyqtarët si rezultat i procedurave penale. Të dhënat nga Prokuroria e Shtetit tregojnë se vetëm 3.8% e kryerësve të dhunës të dënuar u referuan për trajtim të detyrueshëm në vitin 2019 (35 burra nga gjithsej 917 raste dënimesh).

52 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Danimarkë (GREVIO/Inf(2017)14), para. 92: "Rëndësia e programeve efektive për kryerësit e dhunës përveç të ndonjë sanksioni penal nuk mund të nënvlerësohet, dhe as relevanca e tyre për parandalimin (e mëtejshëm)".

53 Si në raportet e mëposhtme: GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Shqipëri (GREVIO/Inf(2017)13); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Portugali (GREVIO/Inf(2018)16); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Turqi (GREVIO/Inf(2018)6).

54 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Shqipëri (GREVIO/Inf(2017)13), para. 71.

55 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14), para 95 seems to apply only to perpetrators with mental health issues referred to community service; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Spanjë (GREVIO/Inf(2020)19), para. 107.

56 Për shembull, është rasti i Austrisë, Danimarkës dhe Finlandës.

57 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Shqipëri (GREVIO/Inf(2017)13), para. 78.

Gjykata vendosi masa të trajtimit të detyrueshëm për kryerësit e dhunë në familje ⁵⁸		
Viti	Gjithsej lëndë të DhF-së që marrin vendim për fajësinë	Masa për trajtimit të detyrueshëm
2015	901	23 (2.6%)
2016	1055	17 (1.6%)
2017	776	11 (2.4%)
2018	537	30 (5.6%)
2019	917	35 (3.8%)
2020 (jan.-shta.)	385	23 (5.9%)

Numri i ulët i referimeve për trajtim mund të interpretohet si pjesërisht i lidhur me nivelet e ulëta të dënimit për dhunën në familje. Disa palë të interesit kanë raportuar gjithashtu se, edhe pse është parashikuar në ligj, këshillimi psikologjik për kryerësit e dhunës përdoret rrallë (RrGK 2018). Në praktikë, vetëm masa mbrojtëse shtesë nxjerrën kur kryerësi i dhunës ka probleme të varësisë (abuzim me alkoolin ose drogën) ose ndonjë lloj problemi të shëndetit mendor, në vend që të konsiderohet sistematikisht si një opsion, në bazë të një vlerësimi të rrezikut. Duke u përqendruar ekskluzivisht në këto kategori specifike të kryerësve të dhunës, legjislacioni dhe praktikat aktuale nuk lejojnë që shumica dërrmuese e kryerësve të dhunës të kenë qasje në çdo lloj trajtimi.

Palë të tjera të interesit gjithashtu kanë theksuar se në shumicën e rasteve vendimet me dënim për kryerësit e dhunës në familje sjellin dënime të ulëta. Megjithatë Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (2016-2020) shpreh qartë nevojën për të siguruar “dënimin e duhur për kryerësit e dhunës” (MD 2016, 9), kryerësit e dhunës në familje shpesh marrin dënime të ulëta dhe madje edhe raste recidiviste shpesh kalojnë vetëm përmes gjobave ose arresteve shtëpiake, masa të vendosura nga gjyqtarët në vend të paraburgimit⁵⁹. Sipas prokurorëve, sanksione të tilla të vogla ndikojnë negativisht në punën e tyre dhe në efikasitetin e përpjekjeve të bashkërenduara në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (ABGJ 2019, 127). Edhe nëse kodi penal është reformuar kohët e fundit, duke mundësuar sanksione më të rrepta, shpesh ndodh që kryerësit e dhunës të dënohen me një dënim të shkurtër dhe, pasi të lirohen, ata do të hakmerren ndaj partnereve të tyre. Në shumicën e rasteve, rreziku nga recidivizmi është me të vërtetë i lartë, siç konfirmohet nga Ministria e Drejtësisë.

Informacion i kufizuar është në dispozicion për mundësitë e trajtimit për kryerësit e dhunës në familje të dënuar në mjedise kujdestarie dhe ato jo-kujdestarie. Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Drejtësisë ka rekomanduar kohët e fundit që shërbimet korrektuese të prezantojnë programe specifike për kryerësit e dhunës në familje ndërsa ata janë akoma në burg. Që nga viti 2019, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përfunduar Njësinë për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve (NjVKB), e cila operon në Qendrën e Paraburgimit të Prishtinës. Qëllimi i këtij subjekti juridik është të korrigjojë, risocializojë dhe ri-integrojë në shoqëri të burgosurit e dënuar. Profesionistët nga NjVKB-ja janë trajnuar fillimisht nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2013 dhe, që nga ajo kohë, ata kanë qenë “duke i trajnuar trajnerët” në disa burgje meshkujsh dhe femrash në të gjithë Kosovën*. Lehtësuesit ofrojnë programe të menaxhimit të zemërimit si në qendrat korrektuese për të rritur ashtu edhe për të mitur, pa ndonjë dallim midis të burgosurve të zakonshëm dhe kryerësve të dënuar të dhunës në familje. Efektiviteti i këtyre përpjekjeve nuk është vlerësuar ende. Duhet të theksohet se këto programe synojnë popullatën e përgjithshme të të burgosurve dhe nuk kanë një perspektivë gjinore dhe një fokus specifik në dhunën me bazë gjinore (shih paragrafin 4.3.3). Mungesa e njohurive se si të zbatohen në mënyrë adekuate programet dhe mungesa e trajnimit të profesionistëve në këtë fushë duket se pengojnë një përgjigje konkrete. Për më tepër, nuk është e qartë nëse këto iniciativa janë në dispozicion në të gjithë territorin e Kosovës* apo vetëm në disa burgje, të tilla si në Prishtinë dhe në qendrën e paraburgimit në Lipjan. Siç rezultoi nga disa intervista me palët e interesit, disa organizata joqeveritare kanë zhvilluar kohët e fundit programe ad-hoc në bashkëpunim me shërbimin korrektues, por për momentin ato nuk janë institucionalizuar zyrtarisht, ato nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nuk parashikojnë kohë të mjaftueshme për të arritur një ndryshim real⁶⁰.

Edhe kur gjykata vendos trajtimin e detyrueshëm të një kryerësi të dhunës, zbatimi praktik i vendimit mbetet sfidë (ABGJ 2019). Në përputhje me dy Udhëzimet Administrative të lartpërmendura dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Ministria e Shëndetësisë ka mandatin për të zhvilluar dhe siguruar

58 Statistikat e siguruar nga Prokuroria e Shtetit, korrik 2020.

59 Statistikat e siguruar nga Prokuroria e Shtetit, korrik 2020.

60 OJQ-të e gatshme për të ndërhyrë në mjedisin e kujdestarisë duhet të licencohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, siç përcaktohet në Udhëzimin Administrativ nr. 17/2013, “për licencimin e subjekteve juridike/organizatave që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare”.

infrastrukturën ndihmëse dhe të nevojshme për të mbështetur sigurimin e trajtimit të kryerësve të dhunës (MD 2016). Në nivelin komunal dhe/ose rajonal, përgjegjësia për adresimin e çështjes bie mbi institucionet shëndetësore publike dhe qendrat për shëndetin mendor (KiE 2017).

Në lidhje me abuzimin me alkoolin dhe substanca, trajtimi sigurohet nga Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (kujdesi shëndetësor parësor), spitalet rajonale, Qendrat e Shëndetit Mendor (kujdesi shëndetësor sekondar) dhe institucione të tilla si Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (IPFK). IPFK trajton raste që referohen nga një gjykatës, prokuror ose policia. Pasi personi të pranohet në spital, profesionistët shëndetësorë janë përgjegjës për trajtimin, ndërsa Shërbimet Korrektuese ofrojnë sigurinë e përgjithshme. IPFK ofron strehim banimi për kryerësit e dhunës të dënuar dhe ka rreth 36 vende, të ndara midis rasteve kur gjykata ka urdhëron vlerësim psikiatrik (12 shtretër) dhe rasteve të kryerësve të dhunës që i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (24 shtretër). Disa palë të interesit kanë theksuar numrin e pamjaftueshëm të shtretërve, nëse krahasohet me numrin e kryerësve të dhunës që kanë nevojë për trajtim dhe kanë ngritur shqetësime për kohëzgjatjen e shkurtër të terapisë, e cila mund të ndryshojë nga disa seanca në disa muaj.

Lidhur me trajtimin psikosocial, ai mund të ofrohet nga profesionistë të licencuar në institucionet shëndetësore dhe sociale si dhe nga OJQ (KiE 2017) ⁶¹. Në disa raste, si në projektin pilot të drejtuar nga Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, strehimoret gjithashtu mund të ofrojnë këtë lloj trajtimi, megjithëse kryerësit e dhunës pranohen nga punëtorët e strehimoreve në një objekt të veçantë dhe me mbështetjen e një psikologu të përkushtuar. Deri më tani, Qendra Sit në Prishtinë duket se e vetmja organizatë që ofron seanca këshillimi për burrat që nuk kanë kaluar nëpër procedura gjyqësore. Si në rastin e pjesëmarrjes së detyrueshme apo vullnetare, në mjedisin gjyqësor, ashtu edhe në sektorin e shëndetësisë, kohëzgjatja e kufizuar e programeve duket se lidhet kryesisht me burimet e kufizuara financiare të alokuara për këtë qëllim. Pa devijuar burimet nga shërbimet e mbështetjes për viktimat, programeve për kryerësit e dhunës duhet t'u alokohet fondi i duhur në mënyrë që të sigurohet një numër i mjaftueshëm i seancave me profesionistë të trajnuar posaçërisht në këtë fushë.

I vetëdijshëm për kufijtë e gjendjes aktuale, në kontekstin e IPA-s së Bashkimit Evropian (Instrumenti për Para-Anëtarësim) 2014-2020, Zyrtari për Barazi Gjinore i Ministrisë së Drejtësisë ka punuar në një projekt-propozim, që synon hapjen e një qendre rehabilitimi për Kryerësit e Dhunës në Familje në Kosovë*, me synimin për të zvogëluar rreziqet e recidivizmit dhe numrin e rasteve që rezultojnë me fatalitet. Për momentin, nuk ka më shumë informacion në lidhje me rezultatet e projektit.

Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse të grave

Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse të grave

- Adoptimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse
- Përfshirja e të gjitha agjencive përkatëse shtetërore dhe subjekteve administrative
- Vendosja e një bashkëpunimi të ngushtë me shërbimet mbështetëse të grave
- Zhvillimi i instrumenteve për bashkëpunim ndërinstitutional, përfshirë protokollet dhe marrëveshjet

i. Standardet ndërkombëtare dhe parimet udhëzuese

Një nga katër shtyllat e Konventës së Stambollit është zbatimi i politikave të koordinuara. Në përputhje me nenet e përfshira në Kapitullin II "Politikat e bashkërenduara" (nen. 7 - nen. 11), shteteve u kërkohet të krijojnë mekanizma të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim efektiv midis gjyqësorit, prokurorëve publikë, agjencive të zbatimit të ligjit, autoriteteve lokale dhe rajonale dhe OJQ-ve. Prandaj, të gjithë partnerët e përfshirë në një përgjigje të koordinuar kundër dhunës ndaj grave, përfshirë organizatat joqeveritare, duhet të financohen në mënyrë adekuate dhe duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në monitorimin dhe vlerësimin e strategjive të zbatuara. Këto dispozita gjithashtu kanë të bëjnë me programet e kryerësve të dhunës.

Ndërsa u kërkohen kryerësve të dhunës përgjegjësi për veprimet e tyre, programet për kryerësit e dhunës duhet t'u japin prioritet nevojave, sigurisë dhe mirëqenies së grave dhe fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje. Me këtë qëllim, është e rëndësishme që programet të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me agjenci të tjera, të tilla si mbrojtja e fëmijëve, shërbimet sociale dhe gjykatat, në mënyrë që të ofrojnë një përgjigje të integruar të komunitetit. Angazhimi i të gjitha agjencive përkatëse shtetërore dhe subjekteve ad-

61 Shih Udhëzimin Administrativ 12/2012, neni 5.

ministrative - përfshirë punonjësit e komunave dhe të shërbimit social, agjentët e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët - mund të kontribuojë në informimin e kryerësit të dhunës për ekzistencën e programeve dhe për mundësinë për t'i ndjekur ato. Në veçanti, duhet të krijohen lidhje të ngushta me shërbimet mbështetëse të grave dhe me strehimoret lokale. Një sistem gjithëpërfshirës i ndërhyrjes që përqendrohet në nevojat e viktimave, së bashku me zhvillimin e protokolleve të bashkëpunimit ndërinstucional, mund të promovojë një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut. Siç është theksuar në udhëzimet e përpunuara nga WWP EN, aleancat ndër-agjenci duhet të pranohen nga politikë-bërësit dhe për këtë arsye duhet të financohen siç duhet, në mënyrë që të shmangët konkurrenca ndër-shërbime për burimet financiare.

Sipas standardeve minimale të Këshillit të Evropës për shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave (Këshilli i Evropës 2008), sapo një kryerës i dhunës të regjistrohet në një program, duhet të ketë gjithmonë një shërbim mbështetës të lidhur ose të asociuar në dispozicion për gratë viktime. Duhet të inkurajohen protokolle të qarta ndërmjet shërbimeve, për të siguruar një shkëmbim efektiv të informacionit dhe procedurave të përbashkëta për vlerësimin e rrezikut dhe progresit (WWP EN n.d.). Marrëveshjet me shërbimet mbështetëse të grave gjithashtu mund të sjellin kufizime në të drejtat e konfidencialitetit të kryerësve të dhunës. Para se të regjistrohet në program, kryerësi i dhunës duhet të pranojë kushte specifike të tilla si ofrimi i adresës së partneve aktuale dhe të ish-partneve dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje për zbulimin e informacionit konfidencial, veçanërisht në rastin e rreziqeve të rritura për sigurinë e viktimave. Partneret gjithmonë duhet të informohen nëse kryerësi i dhunës largohet nga programi, nëse ai është pezulluar për trajtim dhe nëse ka ndonjë shqetësim në lidhje me mirëqenien e grave dhe fëmijëve (Këshilli i Evropës 2008).

Me qëllim të përforsimit të lidhjeve midis shërbimeve mbështetëse të grave dhe programeve për kryerësit e dhunës, WWP EN sugjeron gjithashtu përfshirjen e përfaqësuesve të shërbimeve mbështetëse të grave si ekspertë në komitetet drejtuese ose bordet këshilluese të programeve për kryerësit e dhunës. Udhëzimet e WWP EN nënvizojnë se është përgjegjësi e punonjësve të programit për kryerësit e dhunës të krijojnë bashkëpunime të tilla dhe se duhet të bëhen përpjekje të vazhdueshme në këtë proces (WWP EN n.d.).

ii. *Mostër praktikash nga raportet e GREVIO-s*

Raportet e GREVIO-s kanë nënvizuar vazhdimisht se një bashkëpunim efektiv dhe sistematik me shërbimet mbështetëse të grave është thelbësor në punën me abuzuesit në familje. Aty ku mungonte ky partneritet, GREVIO ka rekomanduar qartë zbatimin e programeve për kryerësit e dhunës në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e specializuara të mbështetjes për t'i dhënë përparësi sigurisë së viktimave⁶². Komiteti konsideron se këto marrëveshje mund të zvogëlojnë rrezikun e viktimizimit sekondar dhe të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave.

GREVIO ka lavdëruar protokollin e miratuar në Austri midis rrjetit kombëtar të shërbimit mbështetës të grave dhe shërbimit sprovues, si dhe praktikën e përfshirjes së një "personi kontakti të partnerit" i ngarkuar për komunikimin dhe bashkëpunimin me viktimën, siç është adoptuar nga programet suedeze për burgje dhe shërbime sprovuese⁶³. Ajo gjithashtu ka vërejtur se ky bashkëpunim nga njëra anë rrit mundësitë për të propozuar trajtim për partnerët abuzues, ndërsa nga ana tjetër siguron që gratë të njoftohen rregullisht për nivelin e bashkëpunimit të partnerit të tyre që ndjek një program - duke ditur që ndryshimet në sjelljet e kryerësve të dhunës mund të përfshijnë progres, por edhe rritje të rrezikut për recidivizëm dhe braktisje.

iii. *Gjendja në Kosovë**

Në Kosovë*, autoritetet kanë promovuar një qasje strategjike në favor të decentralizimit, me qëllim të vënies së shërbimeve në dispozicion në nivelin lokal dhe inkurajimin e bashkëpunimit midis agjencive lokale. Adoptimi i PSV-së dhe krijimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit në secilën komunë kanë përbërë hapa themelorë drejt zbatimit konkret të politikave të koordinuara në parandalimin dhe përgjigjen kundër dhunës ndaj grave në secilin komunitet. Në këtë proces, komunat kanë fituar kompetenca specifike, siç është mundësia e financimit të ofruesve të shërbimeve, përfshirë strehimoret (MD 2016).

Mekanizmat e koordinimit komunal kanë një potencial të konsiderueshëm në promovimin e bashkëpunimit mes shumë agjencive dhe zhvillimin e një qasjeje të përbashkët ndër-disiplinore ndaj dhunës në familje, e cila gjithashtu ka të bëjë me rehabilitimin e kryerësve të dhunës. Sidoqoftë, disa palë të interesit kanë theksuar

62 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14), para 95seems to apply only to perpetrators with mental health issues to community service; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Spanjë (GREVIO/Inf(2020)19), para. 111.

63 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Austri (GREVIO/Inf(2017)4); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Suedi (GREVIO/Inf(2018)15).

pengesa të shumta në zbatimin real të procesit të decentralizimit, duke rezultuar në mungesë të bashkëpunimit midis palëve të interesit dhe në një përgjigje joefektive ndaj dhunës në familje. Në fakt, vetëm një numër i vogël i komunave në Kosovë* kanë krijuar mekanizma koordinimi dhe në shumicën e rasteve këto instrumente janë ende mjaft të dobëta, për shkak të çështjeve të qëndrueshmërisë financiare, burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe mungesës së të kuptuarit të dispozitave të PSV-së. Sipas disa palëve të interesit, decentralizimi është zhvilluar me shpejtësi të madhe dhe profesionistët në terren nuk kishin kohë të mjaftueshme për t'iu nënshtruar trajnimit adekuat dhe as për të ndërtuar kapacitetet thelbësore për marrjen e detyrave të reja. Në praktikë, këto mangësi çojnë në probleme të shumta të koordinimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve, të cilat pasqyrojnë një ndarje të dobët informacioni, menaxhim të dobët të rasteve dhe vlerësim jo të saktë të rrezikut, duke sjellë rrezikun për rrezikim të sigurisë dhe të të drejtave të njeriut të grave. Disa palë të interesit kanë përmendur se një databazë e re e rasteve të dhunës në familje së shpejti do të jetë në dispozicion dhe ata besojnë se do të përmirësojë menaxhimin e koordinuar të rasteve midis shërbimeve⁶⁴.

TË KUPTUARIT 1

Rasti i dhunës në familje që përfshin profesionistë të disa institucioneve

Intervistë nr. 11, mjeku familjar dhe trajneri mbi dhunën në bazë gjinore për profesionistët shëndetësorë

“Si mjeke familjare, unë takova një herë një grua shtatzënë, e cila sapo erdhi për një kontroll të rregullt gjatë shtatzënisë së saj. Ajo ishte grua nga Shqipëria e martuar me një burrë nga Kosova*. Ndërsa po fliste, vura re se ajo ishte e shqetësuar dhe e alarmuar. Ajo filloi të përmendte dhunën në familje. Në Kosovë*, mjekët familjarë kanë këtë shërbim të vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët dhe kështu unë fola me dy infermiere në mënyrë që ato të shkonin ta vizitonin këtë familje në veçanti. Gjatë vizitës ato takuan burrin dhe vunë re se ai ishte roje sigurimi në kopshtin e njërit prej fëmijëve të infermieres. Ato e njohën atë, folën me të ngadalë dhe panë që edhe nëse familja po e mbronte gruan, ai ishte jashtëzakonisht i dhunshëm. Sidoqoftë, infermieret arritën ta sillnin burrin këtu, në klinikë. Unë fola me të, ai dukej si një person normal. Ai ishte shumë xheloz, kishte stereotipe gjinore, pohoi se gruaja e tij duhet të bëjë gjithçka që ai thotë, dhe ai ka abuzuar fizikisht gruan dhe fëmijët e tij”. [...]

Gruaja më në fund raportoi në polici. Burri u hakmor kundër saj duke mos e lënë të shkonte të vizitonte familjen e saj në Shqipëri, sepse në Kosovë* nuk është e pranueshme që policia të vijë në shtëpinë tuaj dhe të flasë për dhunën në familje, e cila ende konsiderohet si çështje private. [...] Policia kishte një bisedë me të. Zakonisht, kur konsiderojnë se ekziston rreziku real i akteve të përsëritura të dhunës, ata e parburgosin kryerësin e dhunës. Sidoqoftë, ky njeri nuk është arrestuar kurrë. Ai ishte shumë i mirë në minimizimin e asaj që bëri dhe vazhdonte të përsëriste se ai ‘thjesht vetëm e kam gërvishur atë’, por unë mund të them se dhuna emocionale dhe verbale kishin qenë të pabesueshme. Ajo ishte vërtet në depresion. [...]

Çifti përfundimisht u divorcua dhe ajo u largua. Ajo mund të merrte njërin nga fëmijët, por burri mbajti dy fëmijët tjerë: kryerësi i dhunës i përdorte ata për ta shantazhuar, duke thënë ‘Shko, ik, divorcohu, por kurrë nuk do t’i shohësh më fëmijët e tu’. [...] Mendoj se do të ishte shumë e rëndësishme që kryerësi i dhunës të marrë pjesë në një program të bazuar në komunitet. Nëse ne nuk punojmë me kryerësit e dhunës nuk mund të kontrollojmë DHBGJ-në në Kosovë*. Edhe nëse kemi urdhra mbrojtjeje, kemi kaq shumë raste kur gruaja vritet *madje me urdhër mbrojtjeje*. Unë mendoj se Qendrat për Punë Sociale si dhe policia dhe profesionistët shëndetësorë duhet të përfshihen në trajnime të tilla, pasi ato merren drejtpërdrejt me kryerësit e dhunës. Të gjithë këta profesionistë duhet të përfshihen në mënyrë që të kenë një përgjigje të suksesshme të bazuar në komunitet”.

Nëse funksionon siç duhet, mekanizmat komunal mund të përfshijnë lehtësuesit e programeve për kryerësit e dhunës dhe pjesëmarrjen e tyre në takime të rregullta me gjyqtarë, avokatë, agjentë të zbatimit të ligjit, punëtorë socialë dhe shërbime të specializuara mbështetëse, për t’u marrë me secilin rast të dhunës në familje dhe për të hetuar se çfarë funksionon në praktikë dhe çfarë shkakton probleme. Decentralizimi dhe bashkëpunimi mes shumë agjencive në nivelin e qarkut mund të luajë rol thelbësor edhe në zbatimin e saktë të programeve për kryerësit e dhunës, duke pasur parasysh veçanërisht parandalimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin. Bashkëpunimi sistematik me shërbimet korrektuese dhe sprovuese dhe me drejtorinë e burgjeve

64 Projekti katër-vjeçar u krijua gjatë një programi të financuar nga BE-ja në bashkëpunim me UN Women dhe ai u zhvillua përmes konsultimeve me disa institucione në nivelin qendror dhe lokal, duke përfshirë gjyqtarë, prokurorë, ofrues shërbimesh sociale dhe shëndetësore, strehimore.

do të ishte i dëshirueshëm dhe mund të funksiononte në faza të ndryshme të procedurave⁶⁵. Për momentin, nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje specifike me këto shërbime. Megjithatë në disa raste protokollet e referimit ekzistojnë, nuk është e qartë se si shërbimet mbështetëse dhe institucionet lokale konkretisht angazhohen me kryerësit e dhunës dhe në çfarë mase parashikohet trajtimi i kryerësve të dhunës në kontekstin e mekanizmave komunalë të koordinimit. Deri më tani, PSV-ja nuk parashikon ndonjë procedurë specifike që synon kryerësit e dhunës. Ndërsa shumica e iniciativave janë përqendruar me të drejtë në gratë viktimat të dhunës, nuk janë marrë parasysh ndërhyrjet me kryerësit e dhunës, të cilat mund të kontribuonin në ofrimin e sigurisë dhe mbrojtjes së viktimave.

Protokollet ose marrëveshjet me shërbimet mbështetëse të grave, që synojnë të ofrojnë mbrojtje dhe siguri për viktimat, duket se mungojnë. Përjashtimi i vetëm është "Shtëpia e Sigurt" në Gjakovë, ku një bashkëpunim midis punëtorëve të strehimore dhe zyrës lokale sprovuese ka filluar në kontekstin e projektit pilot që synon rehabilitimin e kryerësve të dhunës. Disa palë të interesit kanë sugjeruar që, nëse një kryerës i dhunës regjistrohet në një program, mekanizmat komunal të koordinimit mund të mbështesin procedurat e kontaktit me viktimat në mënyrë që të ofrojnë mbrojtje për gratë dhe përcjellje të sjelljes së kryerësit të dhunës. Siç është theksuar nga disa palë të interesit, punëtorët e strehimoreve në Kosovë* janë ndër të paktët profesionistë që në njëzet vitet e fundit kanë zhvilluar njohuri specifike, kanë fituar përvojë në trajtimin e dhunës në familje dhe në sigurimin e një përgjigje institucionale. Bashkëpunimi i strehimoreve dhe shërbimeve mbështetëse të grave në hartimin dhe zbatimin e programeve për kryerësit e dhunës do të ishte i një rëndësie të madhe.

Perspektiva Gjinore dhe standardet minimale për praktikë

Perspektiva gjinore dhe standardet minimale për praktikë

- Adoptimi i një perspektive gjinore
- Prioritetizimi i sigurisë dhe të drejtave të njeriut të grave dhe fëmijëve
- Shmangia e ndërmjetësimit dhe pajtimit të detyrueshëm
- Trajtimi nuk duhet të reduktohet në abuzimin me alkool dhe substanca, menaxhim të zemërimit, mjekim
- Vendosja e procedurave të sigurta të kontaktit me viktimat
- Kryerja e vlerësimit sistematik të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut, në bashkëpunim me shërbime të tjera
- Ofrimi i trajnimit adekuat të profesionistëve
- Mblidhja e të dhënave për kryerësit e dhunës që marrin pjesë në program
- Realizimi i vlerësimeve të rregullta të programeve
- Përcaktimi i një procesi akreditimi dhe i kriterëve të licencimit
- Mbështetja e zhvillimit të një rrjeti kombëtar, përfshirë standardet dhe udhëzimet kombëtare

i. Standardet ndërkombëtare dhe parimet udhëzuese

Konventa e Stambollit u kërkon shteteve palë "të përfshijnë një perspektivë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit të dispozitave të Konventës" (nen. 6, "Politikat me ndjeshmëri gjinore"). Kjo vlen edhe për programet e keqbërësve, pasi puna me kryerësit e dhunës mund të kontribuojë në një proces më të gjerë të ndryshimeve kulturore dhe politike, "drejt heqjes së hierarkive gjinore, dhunës gjinore dhe diskriminimit gjinor" (Këshilli i Evropës 2014). Siç sugjerohet nga udhëzimet e WWP EN, programet duhet të përfshijnë të kuptuarit e ndërlikimeve midis dhunës, pabarazive strukturore dhe marrëdhënieve të pushtetit midis grave dhe burrave, dhe me konstruktonet themelore historike dhe shoqërore të karakterit mashkullor dhe femëror (WWP EN, n.d.).

Adoptimi i një modeli ekologjik (Hagemann-White *et al.* 2010), i cili konsideron ndërveprimin kompleks midis individit, marrëdhënies, komunitetit dhe faktorëve shoqërorë, mundëson të kuptuarit e përbërësve që ndikojnë në sjelljet e kryerësve të dhunës. Edhe pse programet nuk prodhojnë domosdoshmërisht ndryshim në çdo nivel, hulumtimi sugjeron që iniciativat që synojnë kryerësit e dhunës duhet të marrin në konsideratë të gjitha këto shtresa, si dhe ndikimin e tyre në mundësimin ose parandalimin e kryerësve të dhunës që ta mbajnë veten përgjegjës për veprimet e tyre (Këshilli i Evropës 2014). Ndërsa shqyrtojnë të gjithë këta elementë, programet duhet të udhëzojnë një njeri në ndërprerjen e sjelljes së tij të zgjedhur abuzive dhe të mbështesin vendimin e tij në adoptimin e praktikave individuale, alternative, jo të dhunshme, me synimin për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme të bazuara në respekt dhe nocione të barazisë (WWP EN, n.d.).

65 Shih raportin e publikuar nga WWP EN (2019) mbi programet e bazuara në shërbimin sprovues dhe në burgje.

Ashtu si shërbimet e tjera mbështetëse, programet për kryerësit e dhunës duhet ta konsiderojnë dhunën në familje si çështje publike dhe jo private. Një qasje me ndjeshmëri gjinore nxit të kuptuarit e të drejtave të grave si e drejta e individëve - jo vetëm si gra ose nëna të fëmijëve. Veçanërisht, standardet minimale të Këshillit të Evropës theksojnë se siguria dhe mirëqenia e grave dhe fëmijëve duhet të kenë përparësi ndaj përpjekjeve për të ruajtur unitetin familjar me çdo kusht (Këshilli i Evropës 2008). Prandaj, këshillimi, ndërmjetësimi ose pajtimi i detyrueshëm familjar nuk konsiderohen përgjigje të përshtatshme në punën me kryerësit e dhunës, dhe as programet që përqendrohen ekskluzivisht në trajtimin e abuzimit me substanca ose të menaxhimit të zemërimit. Neni 48 i Konventës së Stambollit ndalon proceset alternative të detyrueshme të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ose dënimit. Raporti Shpjegues i konventës paralajmëron për efektet negative të ndërmjetësimit në rastet e mosmarrëveshjeve familjare të shënuara nga dhuna, veçanërisht kur procedurat e tilla i imponohen viktimës. Asimetria e pushtetit midis palëve mund ta bëjë këtë metodë të pafavorshme për gratë dhe të çojë në viktimizim dytësor. Lidhur me abuzimin me alkool dhe substanca, disa organizata në të gjithë Evropën konsiderojnë probleme serioze të varësisë dhe çrregullime antisociale të personalitetit si kritere përjashtimi për regjistrimin në një program të kryerësit të dhunës, pasi që këto çështje meritojnë ndërhyrje të specializuara dhe duhet të trajtohen veçmas nga trajtimi i abuzimit në familje (WWP EN 2019, 7).

Programet në përputhje me standardet ndërkombëtare pritet të inkurajojnë kryerësit e dhunës të shqyrtojnë qëndrimet dhe besimet e tyre ndaj grave. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve duhet të marrin trajnim adekuat mbi abuzimin në familje si formë e dhunës me bazë gjinore (Konventa e Stambollit, Raporti Shpjegues). Për më tepër, programet për kryerësit e dhunës duhet të marrin në konsideratë ndërlidhshmërit e gjinisë me çështje të tjera, të tilla si raca, klasa, mosha, kombësia dhe aftësia e kufizuar.

Në mënyrë që të mbështesin llogaridhënien e kryerësve të dhunës dhe rrugëtimin drejt fuqizimit të grave, programet duhet të shoqërohen me shërbime mbështetëse që synojnë partneren ose ish-partneren. Rekomandohet që profesionistët që punojnë me kryerësit e dhunës dhe të kontaktojnë partneren ose ish-partneren, për ta informuar atë për qëllimet, përmbajtjen dhe kufizimet e programit, si dhe për ta këshilluar atë se si të ketë qasje në shërbimet e specializuara të mbështetjes. Stafit duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se regjistrimi i kryerësve të dhunës në një program mund të ndikojë në vendimin e viktimës për të qëndruar ose për t'u larguar nga abuzuesi ose për t'i dhënë asaj shpresa dhe pritje të rreme. Viktima nuk duhet të ndihet kurrë e detyruar të marrë pjesë, në asnjë rrethanë. Nëse ajo është e gatshme të bashkëpunojë, programet duhet të përdorin me shkathtësi informacionin e dhënë. Viktimat gjithashtu duhet të paralajmërohen për mundësinë që kryerësi i dhunës të mund të përfitojë nga pjesëmarrja e tij për të manipuluar ose kontrolluar më tej atë (Këshilli i Evropës 2014).

Para pranimit në program, duhet të vlerësohet përshtatshmëria dhe motivimi i kryerësve të dhunës. Pjesëmarrësit e pranuar duhet të bien dakord për kufizimet e të drejtave të tyre të konfidencialitetit, të tilla si mundësia për lehtësuesit për të kontaktuar partneren e kryerësit të dhunës ose agjencitë e zbatimit të ligjit, në rast të rritjes së rrezikut për akte të reja të dhunës ndaj grave ose fëmijëve. Për këtë arsye, është e një rëndësie të madhe që programet të kryejnë vazhdimisht vlerësime të rrezikut - të tilla si, për shembull, Vlerësimi i Rrezikut të Sulmit Bashkëshortor (VRrSB) dhe që ata të koordinohen me shërbime dhe institucione të tjera për një menaxhim adekuat të rrezikut. Udhëzimet e WWP EN rekomandojnë përdorimin e vlerësimit të rrezikut dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, që do të ndërmerren dhe dokumentohen në momentin e pranimit, si dhe në kohë të caktuara, gjatë rrjedhës së programit dhe sa herë që sjellja e kryerësit të dhunës ose situata tregon një ndryshim të mundshëm në rrezik (WWP EN, n.d.). Të gjithë profesionistët e përfshirë duhet të pranojnë që rreziku mund të ndryshojë vazhdimisht me kalimin e kohës, për shkak të elementeve të shumta të ndryshueshme (Gondolf 2012). Në bazë të vlerësimeve të rregullta, lehtësuesit mund të adoptojnë plane sigurie për të siguruar mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, si dhe ata mund ta referojnë kryerësin e dhunës në shërbime të tjera, për t'i adresuar nevojat e tij specifike (p.sh. programet për trajtimin e varësisë). Faktorët në zhvillim e rrezikut mund të përfshijnë keqpërdorimin e substancave, situata me rrezik të lartë ose cenueshmëritë e viktimave (WAVE 2017). Vlerësimi mes shumë agjencive i faktorëve të tillë mund të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e profesionistëve të tjerë, përkatësisht punonjësve në shërbimet mbështetëse të grave, në sektorin shëndetësor ose në shërbimet për fëmijë, mund të ndihmojë për të kuptuar dinamikën e një marrëdhënieje dhe për të reaguar në mënyrë adekuate (WWP, n.d.).

Standardet minimale të Këshillit të Evropës (2008) gjithashtu ofrojnë indikacione në lidhje me arsimimin profesional të lehtësuesve, të cilët duhet t'i nënshtrohen të paktën 30 orëve të trajnimit të specializuar. Kurrikula duhet të përfshijë, midis temave të tjera, një analizë gjinore të dhunës ndaj grave, nocione mbi vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut, të kuptuarit e perspektivave të grave dhe përjetimin e fëmijëve, si dhe një vlerësim të modeleve të minimizimit dhe manipulimit të kryerësve të dhunës. Udhëzimet e WWP EN gjithashtu ofrojnë një listë të gjerë të kompetencave të stafit që përmbajnë njohuri, shkathtësi dhe vlera specifike dhe

theksojnë rëndësinë e aftësisë për të menaxhuar tensione dhe dinamikat sfiduese të grupeve (WWP EN, n.d.)⁶⁶.

Për të përmbushur kërkesat e vendosura nga Konventa e Stambollit mbi “mbledhjen dhe hulumtimin e të dhënave” (neni 11), iniciativat që synojnë kryerësit e dhunës duhet gjithashtu të angazhohen në mbledhjen sistematike të të dhënave, si dhe të dokumentojnë dhe vlerësojnë rregullisht praktikën e tyre. Në lidhje me këtë, WWP EN promovon përdorimin e Manualit të Ndikimit (Impact Toolkit), i cili përfshin pyetësorë që kanë për qëllim burrat pjesëmarrës dhe partneret e tyre dhe që përbëhet nga disa faza vlerësimi, gjatë dhe pas programit (WWP EN, n.d.). Së fundmi, programet që synojnë kryerësit e dhunës nuk duhet të operojnë të izoluara: krijimi i një rrjeti kombëtar të programeve për kryerësit e dhunës, së bashku me zhvillimin e kriterëve të qarta të licencimit dhe me adoptimin e standardeve dhe udhëzimeve kombëtare, mundëson që të operojnë në bazë të praktikave dhe parimeve të përbashkëta, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

ii. *Mostër praktikash nga raportet e GREVIO-s*

GREVIO ka nënvizuar vazhdimisht se programet për kryerësit e dhunës duhet të bazohen në të kuptuarit gjinor të dhunës dhe të përfshijnë vazhdimisht zbrëthimin e stereotipave seksiste. Komiteti ka ngritur kritika të forta drejt adoptimit të një qasjeje neutrale ndaj gjinisë⁶⁷.

Në disa raste, GREVIO ka kujtuar rëndësinë e zbatimit të standardeve minimale uniforme që synojnë t’i japin përparësi sigurisë dhe të drejtave të njeriut të grave dhe fëmijëve⁶⁸. Për këtë arsye, në raportin për Shqipërinë, Komiteti ka shprehur shqetësim në lidhje me praktikën përfshirë terapinë familjare, ndërmjetësimin dhe pajtimin në kontekstin e programeve për kryerësit e dhunës⁶⁹. Në rastin e Belgjikës, GREVIO ka vërejtur “një prirje të fortë drejt ‘ndërmjetësimit në dyshe’ në kontekstin e programeve për kryerësit e dhunës. Kështu, ai ka inkurajuar fuqimisht autoritetet kombëtare të kufizojnë përdorimin e kësaj praktike dhe të sigurojnë që viktimat të japin pëlqimin e lirë dhe të informuar përpara se të marrin pjesë⁷⁰.

Në rastin e vendeve të tjera, ndërsa pohoi nevojën për të kuptuarit gjinor të dhunës në familje, Komiteti ka deklaruar që programet që përqendrohen ekskluzivisht në menaxhimin e zemërimit, në problemet e shëndetit mendor dhe në trajtimet e varësisë nuk konsiderohen në përputhje me Konventën e Stambollit. Në raportin për Malin e Zi, GREVIO ka inkurajuar autoritetet kombëtare “të largohen nga programet për kryerësit e dhunës të bazuar ekskluzivisht në trajtimin mjekësor për abuzimin me substanca dhe problemet e shëndetit mendor”⁷¹, ndërsa në raportin për Turqinë, Komiteti ka theksuar faktin se gjykatat dhe institucionet e kujdesit shëndetësor “kanë prirje të barazojnë [programet për kryerësit e dhunës] me trajtimin mjekësor për çrregullimet psikologjike ose problemet e varësisë”⁷². Në rastin e Turqisë, GREVIO gjithashtu ka ngritur shqetësime në lidhje me ofrimin e trajtimit të detyrueshëm mjekësor për kryerësit e dhunës seksuale, duke theksuar se trajtimi i kryerësve të dhunës duhet të jetë gjithmonë i respektueshëm si për të drejtat e njeriut të viktimës ashtu edhe për ato të kryerësit⁷³. Komiteti e ka bërë të qartë se, megjithëse disa kryerës të dhunës mund të kenë disa probleme të mbitheksuara, këto çështje duhet të adresohen veçmas dhe me kategori të ndryshme të profesionistëve. Sipas Grupit të Ekspertëve, zbatimi i saktë i programeve për duhet fillimisht “të inkurajojnë kryerësit e dhunës të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të shqyrtojnë qëndrimet dhe bindjet e tyre ndaj grave”⁷⁴.

Përmes këtyre rreshtave, GREVIO ka mirëpritur procesin e akreditimit të zhvilluar nga rrjeti kombëtar italian Relive, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira, si dhe nismat e nisura në Finlandë dhe Austri, që synojnë krijimin e standardeve të cilësisë dhe udhëzimeve koherente për programet e kryerësve të dhunës në të gjithë vendin. GREVIO shpesh i ka inkurajuar institucionet kombëtare të miratojnë këtë proces⁷⁵ harmonizimi dhe ka theksuar rëndësinë e sigurimit të trajnimit adekuat të profesionistëve, mbledhjen sistematike të të dhënave dhe vlerësimin e vazhdueshëm të programeve. Në veçanti, Komiteti ka theksuar në mënyrë të përsëritur rëndësinë e vlerësimit të ndikimit afatshkurtër dhe afatgjatë të programeve duke analizuar pjesëmarrjen dhe normat e përsëritjeve të shkeljeve me qëllim të matjes së efektivitetit të tyre në parandalimin e akteve të reja dhe më të rënda të dhunës⁷⁶.

66 Shih në veçanti paragrafin B5 “Kompetencat e stafit”.

67 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Holandë (GREVIO/Inf(2019)19), para. 106. Shih edhe GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14), para. 95.

68 Raportet e GREVIO-s shpesh i referohen minimumit të Këshillit të Evropës standardet për shërbimet mbështetëse (Këshilli i Evropës 2008). Shih për shembull GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Serbi (GREVIO/Inf(2019)20); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Shqipëri (GREVIO/Inf(2017)13).

69 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Shqipëri (GREVIO/Inf(2017)13), para. 70.

70 Shih edhe GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14), para. 95.

71 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Mal i Zi (GREVIO/Inf(2018)5), para. 91.

72 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Turqi (GREVIO/Inf(2018)6), para. 124.

73 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Turqi (GREVIO/Inf(2018)6), para. 130.

74 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Mal i Zi (GREVIO/Inf(2018)5), para. 91.

75 Si në raportet e mëposhtme: GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Portugali (GREVIO/Inf(2018)16); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Francë (GREVIO/Inf(2019)16); GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Suedi (GREVIO/Inf(2018)15).

76 GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Andorrë (GREVIO/Inf(2020)18), para. 84; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Maltë (GREVIO/Inf(2020)17), para. 86; GREVIO, Raporti i Vlerësimit Bazë: Belgjikë (GREVIO/Inf(2020)14), para. 95.

iii. *Gjendja në Kosovë**

Megjithëse në vitet e fundit Kosova* ka zhvilluar njohuri të rëndësishme në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, intervistat me palët e interesit kanë zbuluar një mungesë të të kuptuarit të qëllimit dhe funksionimit të programeve për kryerësit e dhunës: cilat janë ato, si duhet të zbatohen, dhe cili është roli i tyre në një përgjigje të koordinuar ndaj dhunës në familje. Disa aktorë kanë vërejtur mungesën e institucioneve të specializuara që punojnë me kryerësit e dhunës në familje dhe nuk e pranojnë qasjen aktuale, ku trajtimi synon vetëm personat me probleme të shëndetit mendor dhe me probleme të alkoolit ose të drogës (ABGJ 2019)⁷⁷.

Legjislacioni dhe politikat aktuale që fokusohen tek kryerësit e dhunës nuk kanë perspektivë gjinore dhe kanë mungesë të të kuptuarit të dhunës në familje si çështje publike. Udhëzimet Administrative nr. 12/2012 dhe nr. 02/2013 nuk ofrojnë të kuptuarit e dhunës si të ndërlidhur me pabarazitë strukturore dhe marrëdhëniet e pushtetit midis grave dhe burrave ose si element i rëndësishëm i konstruktit social të karakterit mashkullor. Sipas palëve të shumta të interesit, në Kosovë* dhuna e burrave ndaj partnereve intime konsiderohet ende zakonisht si rezultat i abuzimit me alkoolin dhe drogën ose i problemeve të shëndetit mendor dhe shpesh lidhet me papunësinë, analfabetizmin dhe varfërinë. Megjithëse disa nga këta elementë mund të shqyrtohen si faktorë rreziku që kontribuojnë, dhuna në familje duhet të synohet si “formë e dhunës që prek gratë në mënyrë jo proporcionale dhe e cila është në mënyrë të veçantë gjinore” (Konventa e Stambollit, Raport Shpjegues, para. 42). Po kështu, kryerësit e dhunës duhet të trajtohen si burra që përdorin qëllimisht dhunë për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi partneret e tyre, pavarësisht nga faktorë të tjerë.

Bashkëpunimi midis gjyqtarëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor është thelbësor në përcaktimin nëse një trajtim i shëndetit mendor duhet të imponohet apo jo. Gjykatat mund të urdhërojnë trajtim të detyrueshëm në bazë të një ekspertize mjekësore. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (IPFK) është përgjegjës për kryerjen e një vlerësimi psikiatrik të rasteve të referuara nga një gjyqtar, prokuror ose policia, dhe përcakton gjendjen psikiatrike të shkelësit në kohën e kryerjes së krimit. Midis numrit të plotë të rasteve, kryerësit e dhunës në familje përbëjnë vetëm një komponentë të vogël të një grupi të gjerë të shkelësve. Në këtë kontekst, profesionistët e IPFK-së vlerësojnë nëse çrregullimet mendore mund të konsiderohen në rënjen e abuzimit të partnerit intim apo jo. Në varësi të gjetjeve, ekipi i vlerësimit mund të propozojë masa për trajtimin kujdestar të detyrueshëm në ambientet e IPFK-së ose trajtimin jo-kujdestar në një qendër të shëndetit mendor. Nëse konsiderohet e panevojshme, ekipi i IPFK-së gjithashtu mund të propozojë asnjë trajtim fare. Në këtë rast, gjykata vendos për rastin dhe thjesht mund të zgjedhë paraburgimin. Nëse kryerësit e dhunës nuk kanë ndonjë problem të shëndetit mendor ose ndonjë problem të varësisë, ai ka shumë të ngjarë të mos referohet në ndonjë program, i cili mund të sjellë disa rreziqe për viktimën - qoftë nëse kryerësi i dhunës vuan një dënim me burg ose nëse lirohet, pas një periudhe paraburgimi.

Në rast se gjykata imponon trajtim mjekësor të detyrueshëm, institucionet shëndetësore publike dhe qendrat e shëndetit mendor, duke përfshirë IPFK-në, atëherë janë të ngarkuar me furnizimin me terapi, e cila kryesisht përbëhet nga ilaçe. Vlerësimi i bërë nga Agjencia për Barazi Gjinore zbuloi se këto masa nuk janë zbatuar në masë të gjerë (ABGJ 2019). Sidoqoftë, raporti nuk mund të përcaktojë nëse zbatimi i paketë i trajtimit varet nga personeli mjekësor apo nga mungesa e vendosjes së kësaj mase nga gjykatat. Për këtë arsye, mjekët duket se veprojnë *ad hoc* kur merren me raste të dhunës në familje dhe nuk kanë një sistem specifik referimi për raste të tilla brenda institucionit të tyre (ABGJ 2019).

Kur një kryerës i dhunës pranohet në IPFK, një ekip profesionistësh i vlerëson nevojat e personit dhe bën një plan individual trajtimi. Në rast se terapia është e suksesshme dhe personi tregon ndonjë ndryshim pozitiv, stafi mund të paraqesë një kërkesë në gjykatë, në mënyrë që t'i japë fund trajtimit të detyrueshëm në një mjedis të mbyllur kujdestarie dhe të ndjekë në një mjedis të hapur jo-kujdestarie. Pasi gjykata të vlerësojë kërkesën dhe të vendosë për rastin, pacientët e lejuar të largohen nga IPFK-ja vendosen në një qendër të shëndetit mendor, e cila bëhet institucioni përgjegjës për trajtimin dhe merr përsipër detyrën t'i raportojë rregullisht gjykatës për gjendjen mendore të personit.

77 Ky informacion në veçanti rezulton nga intervistat me gjyqtarët (ABGJ 2019, 133).

TË KUPTUARIT 2

Kryerës i dhunës në familje i trajtuar në IPFK

Intervistë nr. 10, psikiatër, Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Kosovë

“Në një rast u pa e nevojshme që të merreshim me një djalë të ri, një i diplomuar universiteti, 29 vjeç, i martuar, baba i dy fëmijëve të vegjël. Ai ishte akuzuar për rrahje të gruas së tij dhe më pas edhe të babait të tij dhe gjykata propozoi një trajtim të detyrueshëm psikiatrik në IPFK. Stafi bëri një vlerësim dhe arriti në përfundimin se dhuna ishte rezultat i një çrregullimi mendor dhe abuzimit të substancave psikotrope. Në të kaluarën, burri kishte marrë një trajtim të mëparshëm psikiatrik gjatë një viti, por sapo ai kishte ndaluar terapinë e tij, gjendja e tij u përkeqësua. Në IPFK, ai u trajtua për 8 muaj me ilaçe dhe mori trajtim psikosocial në Institut. Ai gjithashtu mund të përfitonte nga disa ‘fundjava terapeutike’ me familjen, si një lloj ‘terapije në grup’. Në fund ai ishte relativisht i qëndrueshëm me përmirësime të dukshme. Stafi i IPFK-së ka propozuar të ndryshojë trajtimin nga trajtimi kujdestar i detyrueshëm në trajtim në liri dhe aktualisht jemi duke pritur vendimin e gjykatës për këtë”.

Disa bashkëbisedues kanë ngritur shqetësime lidhur me efektivitetin e terapisë mjekësore, e cila mund të sigurohet për disa javë, muaj apo edhe vite, pa ndonjë vlerësim ose përcjellje për sa i përket ndryshimeve në qëndrimet, bindjet dhe sjelljet e kryerësve të dhunës ndaj grave. Stafi i IPFK-së gjithashtu ka deklaruar që vendimet e gjykatave për një rast mund të jenë një proces i gjatë, duke rezultuar në atë që kryerësi i dhunës të ngel i mbërthyer në institut për një kohë shumë të gjatë.

Të intervistuar të tjerë kanë theksuar rrezikun e shkeljes së të drejtave të njeriut të kryerësve të dhunës duke kufizuar shkelësin në një pavijon psikiatrik dhe duke e detyruar atë për një trajtim mjekësor. Në një spital të përgjithshëm, ku psikiatrit merren me shumë çështje të ndryshme, kryerësit e dhunës në familje mund të bëhen objekt gjykimi dhe stigmatizimi. Disa palë të interesit gjithashtu kanë ngritur dyshime nëse personi vihet në gjendje të pranojë trajtimin bazuar në një formular pëlqimi të informuar. Sipas informacionit të marrë, megjithëse trajtimi mjekësor mund të jetë përkohësisht efektiv, duke qetësuar shkelësin dhe duke kufizuar sjelljen e tij agresive, në rastin e kryerësve të dhunës në familje nuk duket se është bërë gjë për të adresuar abuzimin ndaj partneres si sjellje të zgjedhur vet. Të intervistuarit kanë theksuar nevojën për një psikoterapi të vërtetë afatgjatë me kryerësit e dhunës, duke u marrë me ta individualisht dhe në seanca në grupe, duke përfshirë si ndërhyrjet e hershme ashtu edhe rastet me rrezik të lartë. Palët e konsultuara të interesit gjithashtu kanë theksuar që personeli klinik që siguron trajtimin nuk i nënshtrohet domosdoshmërisht trajnimeve specifike për DHBGJ dhe DHF dhe duhet t’u sigurojë trajtim kryerësve të dhunës përveç ngarkesës së tyre të rregullt me punë.

Sipas informacionit të marrë, edhe kur profesionistët deklarojnë të zbatojnë një vlerësim të rrezikut, nuk duket se përqendrohet në karakteristikat specifike të dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje. Është edhe më alarmante të theksohet se, si pasojë e kalimit drejt trajtimit mjekësor jo-kujdestar, disa pacientë mund të përfitojnë nga “fundjavat terapeutike” me familjen, pa vlerësim të ndryshimeve të ndodhura në marrëdhënie ose vlerësim të rrezikut për më shumë dhunë ndaj partneres. Nuk është e qartë nëse instrumenti i vlerësimit historik, klinik dhe të rrezikut (HKRr) i adoptuar nga IPFK merr parasysh aspekte specifike në lidhje me dhunën në familje. Siç përcaktohet me standardet ndërkombëtare, është e një rëndësie të madhe që programet për kryerësit e dhunës të mos inkurajojnë pajtimin dhe është edhe më e rëndësishme që ato të bëjnë vlerësimin sistematik të rrezikut në kohë të caktuara për të vlerësuar gjendjen aktuale, duke bashkëpunuar me shërbime të tjera, të tilla si shërbimet mbështetëse të grave.

Sa u përket programeve për kryerësit e dhunës në ambiente kujdestarie, pjesëmarrja në trajnime për menaxhimin e zemërimit mund të propozohet nga Shërbimi Korrektues dhe të mbahet në burg vullnetarisht. Profesionistët që punojnë në Njësinë për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve (NjVKB) përdorin një qasje kognitive të sjelljes në mënyrë që ta bëjnë shkelësin (mashkull ose femër) më të vetëdijshëm për gjendjen e tij/saj emocionale dhe ta mësojnë atë t’i kontrollojë sjelljet e veta. Qëllimi është që të rritet përgjegjësia e shkelësit dhe të vetëdijësohet për pritjet e tij/saj dhe qëndrimet fajësuese ndaj njerëzve të tjerë. Programi i menaxhimit të zemërimit është strukturuar në disa module dhe, megjithëse bazohet në standarde ndërkombëtare dhe në një metodologji specifike, kurrikula nuk përfshin një perspektivë gjinore dhe as nuk parashikon ndonjë qasje të veçantë që synon kryerësit e dhunës në familje. Qëndrimet dhe besimet rreth roleve gjinore dhe vendit të grave në shoqëri nuk diskutohen në programe dhe as nuk e bëjnë objekt të moduleve specifike. Në bazë të një vlerësimi pozitiv mbi ndryshimet personale, pjesëmarrësit mund të gëzojnë disa përfitime,

duke përfshirë “fundjavat në shtëpi” ose lirimin me kusht. Sidoqoftë, vendime të tilla duket se bazohen vetëm në një formular të vlerësimit të rrezikut të “zhvillimit moral”, ndërsa nuk duket se përdoren mjete specifike të vlerësimit të rrezikut për kryerësit e dhunës në familje. Bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit, Qendra e Kosovës për Trajtimin e Traumës (QKTT), një institucion privat siguron që efektiviteti i programit të monitorohet rregullisht. Sidoqoftë, nuk është e qartë se në çfarë mase merren parasysh rastet që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore. Stafit që punon për NjVKB pajtohet mbi nevojën për të prezantuar një program specifik për t’u marrë me kryerësit e dhunës në familje. Profesionistët gjithashtu konsiderojnë që kjo popullatë specifike duhet të trajtohet në grup, pasi ata kanë karakteristika të ngjashme: shumica e kryerësve të dhunës në familje janë burra, të cilët minimizojnë abuzimin e tyre dhe normalizojnë dhunën ndaj grave dhe partnerëve të tyre si një sjellje të pranueshme.

Standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare ofrojnë shumë indikacione të hollësishme në lidhje me trajnimin e profesionistëve që merren me kryerësit e dhunës në familje. Sipas informacionit të marrë, në Kosovë* vetëm disa profesionistë në Shtëpinë e Sigurt në Gjakovë dhe në Qendrën Sit në Prishtinë kanë marrë pjesë në trajnime mbi specifikat e punës me këtë popullatë. Përveç hyrjes fillestare në temë, të gjithë profesionistëve të ngarkuar me punën me kryerësit e dhunës duhet t’u ofrohen disa module trajnimi, që synojnë trajtimin e çështjeve themelore të tilla se si të përfshijnë perspektivën gjinore, se si të krijojnë procedura për t’i kontaktuar partneret femra dhe se si të bëjnë vlerësime adekuate të rrezikut.

Siç raportohet nga disa palë të interesit, shumica e profesionistëve që veprojnë në polici, në shërbimet spruvuese dhe korrektuese, si dhe në sistemin e burgjeve dhe në sektorin e shëndetësisë, nuk janë të vetëdijshëm për dinamikën e një marrëdhënie abuzive dhe nuk janë të përgatitur të merren me kryerësit e dhunës në familje. Puna me kryerësit e dhunës shpesh ndërmerret si pjesë e shërbimeve të tyre të përgjithshme, pa një fokus specifik në dhunën me bazë gjinore dhe pa u mbështetur në stafin e specializuar dhe me përvojë. Në veçanti, punëtorët e QPS-ve duket se nuk e përfillojnë abuzimin e partnereve intime dhe pasojat e tij mbi gratë dhe fëmijët, pasi që praktikën e tyre shpesh synojnë nxitjen e pajtimit të çifteve dhe “rehabilitimin” e bashkimit familjar. Në lidhje me këtë, Agjencia për Barazi Gjinore ka theksuar që programet që synojnë trajtimin e kryerësve të dhunës në familje nuk duhet të bazohen në këshillimin familjar, ndërmjetësimin ose pajtimin (ABGJ 2019, 154).

Në përgjithësi, trajnimi duhet të sfidojë qëndrimet e përhapura patriarkale midis kategorive të ndryshme të profesionistëve. Disa bashkëbisedues kanë raportuar raste të gjyqtarëve, agjentëve të zbatimit të ligjit dhe punëtorëve socialë, që veprojnë në bazë të ideve konservatore mbi vendin dhe rolin e burrave dhe grave brenda familjes. Kjo ndodh shpesh gjatë vendimeve mbi kujdestarinë e fëmijëve në raste të divorcit, ku kryerësi i dhunës, megjithë sjelljen e tij abuzive ndaj gruas dhe fëmijëve, mund të marrë kujdestarinë e plotë në varësi të rolit të tij të njohur si “kryefamiljar” dhe mbajtësi kryesor i familjes.

TË KUPTUARIT 3

Mungesa e vlerësimit të rrezikut në vendimet mbi kujdestarinë e fëmijëve

Intervistë nr. 8, psikiatër, Qendra Klinike Universitare

“Unë jam marrë me raste të ndryshme të dhunës në familje. Njëri prej tyre është rasti i një çifti ku burri ishte biznesmen dhe gruaja amvise. Ai ishte i dhunshëm dhe zonja e gjorë mendoi se ajo duhej të rrinte në shtëpi për t’u kujdesur për fëmijët, jo sepse ajo e donte burrin. Më në fund ajo vendosi të divorcohej por, gjatë procedurës, gjyqtari po i thoshte se nuk kishte para të mjaftueshme për t’i mbajtur fëmijët. Zonja u gjend në një rrugë pa krye: në njërin anë kishte burrin e saj, i cili po e kërcënonte dhe po e abuzonte fizikisht, ndërsa në anën tjetër kishte gjyqtarin, i cili po i thoshte se kujdestaria e fëmijëve do t’i jepej burrit të saj për shkak të gjendjes së saj ekonomike. Gjyqtari nuk e konsideroi faktin që burri ishte i dhunshëm ndaj gruas. Dhe ky nuk është rasti i vetëm; kemi shumë raste si ky, ku gjyqtari nuk vendos në bazë të një vlerësimi të rrezikut, por vetëm në bazë të faktit se burri ka një punë dhe zotëron shtëpinë, ndërsa gruaja nuk ka lehtësira, as para të mjaftueshme për të ushqyer dhe kujdesur për fëmijët”.

Është e një rëndësie të madhe që profesionistët në institucione të ndryshme t’i nënshtrohen trajnimit specifik mbi të kuptuarit e dhunës në familje dhe se si të merren me kryerësit e dhunës, si të bëjnë vlerësim të rrezikut, si të marrin pjesë në përgjigje mes shumë agjencive për të frenuar dhunën e kryerësit e dhunës dhe për të parandaluar format e reja të abuzimit. Profesionistët e vijës së parë në sektorin shëndetësor - të tillë si mjekë

të përgjithshëm, pediatër, infermierë, gjinekologë dhe obstetër - si dhe punëtorët social komunal, mund të luajnë rol vendimtar në identifikimin e një kryerësi dhune, ta referojnë atë në një shërbim të specializuar, ta monitorojnë sjelljen e kryerësit të dhunës dhe ndikimin në njësinë e familjes, pasi ai të ketë përfunduar një program ose sapo të lirohet nga burgu⁷⁸. Në këtë aspekt, punëtorët e QPS-ve janë figura kryesore, pasi ata janë të ngarkuar me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të grave dhe fëmijëve që kanë qenë të ekspozuar ndaj dhunës në familje.

Bashkëpunimi ndër-institucional midis shërbimeve duhet të bazohet në të kuptuarit gjinor të dhunës dhe në standardet minimale për praktikë, veçanërisht në ndarjen e informacionit dhe vlerësimin e rrezikut. Të gjithë profesionistët e përfshirë duhet të jenë të vetëdijshëm se situata mund të ndryshoj shpejt nga një rrezik i ulët në një rrezik të lartë. Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të merret në konsideratë që përgjigja mes shumë agjencive ndaj dhunës së kryerësit mund të jetë veçanërisht delikate në komunitetet e vogla, ku profesionistët e vijës së parë shpesh janë shumë të frikësuar për të raportuar raste të dhunës në familje, pasi ata kanë frikë nga hakmarrja e kryerësit dhe mbrojtja e pamjaftueshme nga agjentët të zbatimit të ligjit. Mungesa e njohurive mbi dhunën në familje, së bashku me mungesën e perspektivës gjinore dhe kompetencat e pakta se si të merren me kryerësit e dhunës, shpesh mund të çojnë në vlerësime joadekuate të rrezikut që sjell pasoja të rrezikshme për sigurinë e viktimave.

4.4. Konkluzione

Të gjithë elementët e mësipërm duket se kontribuojnë në zbatimin e kufizuar dhe të pasaktë të programeve të kryerësve të dhunës në familje në Kosovë* dhe në numrin e ulët të kryerësve të dhunës që i nënshtrohen trajtimit. Programet e menaxhimit të zemërimit në qendrat e paraburgimit, dhe as trajtimi i shëndetit mendor të ofruar në spitalet psikiatrike, duket se nuk përmbushin standardet për programet për kryerësit e dhunës, siç janë krijuar nga standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira. Programet ekzistuese eksperimentale që synojnë kryerësit e dhunës në familje, të tilla si projekti pilot i iniciuar nga Shtëpia e Sigurt në Gjakovë ose seancat e këshillimit të propozuara nga Qendra Sit në Prishtinë, janë zhvilluar në mënyrë të izoluar dhe gjithashtu duhet të sigurojnë pajtueshmëri me standardet.

Institucionet qeveritare si Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia për Barazi Gjinore, së bashku me organizatat lokale të shoqërisë civile, mund të luajnë rol në transformimin dhe harmonizimin e praktikave ekzistuese, me qëllim të (1) dakordimit për një qasje të përbashkët, (2) zhvillimit të njohurive dhe kompetencave për trajtimin e kryerësve të dhunës, (3) përcaktimit të kriterëve të licencimit për organizatat përgjegjëse, (4) ofrimit të trajnim adekuat për profesionistët dhe (5) adoptimit të udhëzimeve të qëndrueshëm në të gjithë territorin e Kosovës*. Për më tepër, do të ishte thelbësore edhe integrimi i punës me kryerësit e dhunës në Procedurat Standarde të Veprimit. Për më tepër, duhet të zbatohen strategji efektive për të mbledhur dhe ndarë të dhënat për kryerësit e dhunës, në mënyrë që të monitorohen rregullisht progresi dhe mangësitë. Për këtë arsye, databaza e re e Kosovës* mbi rastet e dhunës në familje mund të përdoret si mjet për të monitoruar sjelljet e kryerësve të dhunës dhe rreziqet nga recidivizmi.

78 Në lidhje me këtë, kontrolloni «Udhërrëfyesin për profesionistë të vijës së parë që ndërveprojnë me meshkuj kryerës të dhunës në familje dhe abuzim» të hartuar nga ENGAGE (2018) dhe gjendet këtu: https://www.work-with-perpetators.eu/fileadmin/WWP_Network/redakteure/Projects/ENGAGE/Final_roadmaps/engage_EN_191127_web.pdf

5. Programet dhe praktikat nga rajoni i Ballkanit

Në vitet e fundit, në Ballkan janë zhvilluar disa nisma që synojnë programet për kryerësit e dhunës. Ky kapitull sjell në fokus zbatimin e programeve të tilla në Shqipëri dhe në Kroaci. Gjithashtu ofron një listë të organizatave që punojnë me kryerësit e dhunës në familje në rajon (Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi) dhe anëtarëve të Rrjetit Evropian të Punës me Kryerësit e Dhunës.⁷⁹ Këto iniciativa mund të shërbejnë si shembuj për të ilustruar konceptimin dhe zbatimin praktik të programeve për kryerësit e dhunës diku tjetër, megjithëse ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht praktikat më të mira të njohura plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare.

SHQIPERIA

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD)⁸⁰ i krijuar nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, është linja e parë telefonike kombëtare për viktimat e dhunës në familje në Shqipëri. Sot LKBD punon në bashkëpunim me gjykatat, shërbimin sprovues dhe agjencitë e tjera shtetërore. Ajo është e përkushtuar të ofrojë këshillim për kryerësit e dhunës, si dhe nxitje të aktiviteteve parandaluese dhe edukuese për të ndihmuar në krijimin e një komuniteti në të cilin dhuna nuk tolerohet. LKBD-ja është një organizatë anëtare e WWP EN.

Që nga viti 1994, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGJ) ka ofruar shërbime mbështetëse për gratë viktime të dhunës në familje në Tiranë. Linja telefonike ishte njëra nga organizatat kryesore të shoqërisë civile që promovonte miratimin e Ligjit Nr. 9669/2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare". Në vitin 2010, LKGJ-ja vendosi të zhvillojë një shërbim të veçantë që synon rehabilitimin e kryerësve të dhunës në familje. Fillimisht, profesionistët filluan së pranuari partnerë meshkuj të grave që ishin akomoduar në strehën e tyre dhe ofruan seanca këshillimi individuale me një psikiatër. Kjo praktikë eksperimentale pilot tregoi potencialin e punës me ata që kryejnë abuzimin dhe për pasojë zhvilluan një projekt të plotë të filluar në vitin 2010 dhe të mbështetur nga Iamaneh Zvicër⁸¹. Së pari, LKGJ-ja realizoi një vlerësim kombëtar të nevojave, për të identifikuar kërkesa konkrete të shprehura nga shërbimet dhe institucionet lokale në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës. Në vitin 2011, disa profesionistë - kryesisht psikologë dhe punëtorë socialë - iu nënshtruan një trajnimi dy-vjeçar duke u përqendruar në punën me kryerësit e dhunës, të ofruar nga Iamaneh Zvicër dhe duke përfshirë vizita studimore në qendrat zvicerane të Bazelit dhe Cyrihut. Në nëntor të vitit 2012, Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD) u përrua zyrtarisht në Tiranë.

Përveç ofrimit vullnetar të seancave të këshillimit për kryerësit e dhunës, me kalimin e viteve LKBD-ja ka punuar me gjykatat dhe me Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar një sistem referimi për programet e detyrueshme për kryerësit e dhunës mbi bazën e një dënimi gjyqësor. Sot, kryerësit e dhunës nga disa rrethe shqiptare mund të drejtohen në një program të urdhëruar nga gjykata në LKBD. Përveç kësaj, marrëveshje *ad hoc* janë nënshkruar me Zyrën e Provës dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të lejuar trajtimin e kryerësve të dhunës brenda sistemit të vuajtjes së dënimit. Kryerësit e dhunës që regjistrohen në një program

79 Më shumë informata në listen e anëtarëve të WWP EN, në: <https://www.work-with-perpetrators.eu/about-us/members/list-of-network-members>

80 Më shumë informata gjenden në: <https://hotlinealbania.org/>

81 Më shumë informata gjenden në: <https://www.iamaneh.ch/en/>

duhet të marrin pjesë në të paktën 16 seanca javore deri në 30 seanca. Parandalimi i braktisjes dhe sigurimi i pjesëmarrjes së qëndrueshme si në ambient kujdestarie ashtu edhe në atë jo-kujdestarie janë identifikuar si sfida serioze, si dhe nevoja për përcjellje të kryerësit të dhunës kur të lirohet nga burgu, në mënyrë që të shmanget recidivizmi.

LKBD-ja ka bërë përpjekje të rëndësishme në trajnimin e profesionistëve të ndryshëm edhe jashtë Tiranës. Me mbështetjen e disa donatorëve⁸² ndërkombëtarë, LKBD-ja ka ofruar trajnime të shumta për zyrtarët e burgjeve dhe provave në të gjithë vendin. Ata kanë zhvilluar një projekt të përbashkët, midis viteve 2017 dhe 2018, së bashku me Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD) të themeluar në vitin 2014, për të trajnuar këshilltarë të rinj në rajonin e Shkodrës⁸³. Në bazë të një partneriteti të mëparshëm me Qendrën Sit në Prishtinë, themeluesi i kësaj organizate ishte gjithashtu i ftuar të marrë pjesë në këtë projekt trajnimi. Kohët e fundit, LKBD-ja gjithashtu ka identifikuar nevojën për të ofruar module specifike trajnimi mbi sjelljet e varësisë - duke përfshirë varësinë nga alkooli dhe droga, bixhozi, etj. - në mënyrë që këto çështje të trajtohen veçmas dhe kryerësit e dhunës të orientohen drejt qendrave të specializuara të rehabilitimit. Modulet e ardhshme të trajnimit do të përqendrohen edhe në punën me kryerësit të dhunës seksuale, e cila do të integrohet në reformat e vazhdueshme gjyqësore dhe politikave e reja që synojnë adresimin e dhunës seksuale dhe përdhunimit në Shqipëri. Ndërsa fillimisht të gjithë këshilltarët që merreshin me kryerësit e dhunës ishin burra, LKBD-ja ka filluar të trajnojë profesioniste femra.

Lidhur me legjisllacionin, ndryshimet e kohëve të fundit në Ligjin "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhënie Familjare" përfshijnë masa të reja në lidhje me kryerësit e dhunës. Ndryshimet e miratuara në nëntor 2020 i mundësojnë policisë të urdhërojë dëbimin e menjëhershëm të kryerësit të dhunës nga vendbanimi i tij pa pasur nevojë të përdoret një vendim gjykate. Për më tepër, ata përcaktojnë që kryerësit të dhunës do t'i duhet të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale, të cilat mund të merren në konsideratë gjatë vlerësimeve të rrezikut dhe të vlerësohen në vendimet për të drejtat e vizitës ose dënimet e reduktuara.

Një draft i standardeve kombëtare për punën me kryerësit e dhunës është kompletuar kohëve të fundit nga një grup punues ndërinstitucional i drejtuar nga LKBD dhe LKGV, i cili përfshinte Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Zyrën e Provës, si dhe akademikë nga Universiteti i Psikologjisë dhe i Shkencave Sociale në Tiranë. Ky draft së pari do të diskutohet me shërbimet e reja të krijuara për kryerësit e dhunës në disa qytete shqiptare dhe më pas do të paraqitet për shqyrtim në organizata të tjera të shoqërisë civile dhe agjencitë shtetërore deri në adoptimin e tij përfundimtar. LKBD gjithashtu ka nënshkruar protokolle dhe marrëveshje të reja me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe aktualisht është në proces të krijimit të udhëzimeve specifike për zyrtarët e burgjeve dhe sprovues se si të punojnë me kryerësit e dhunës.

Që nga themelimi i saj, LKBD-ja është pjesë e WWP EN dhe merr pjesë aktive në takime vjetore dhe vizita studimore. Gjatë viteve ajo ka zhvilluar edhe shkëmbime joformale dhe partneritete të përbashkëta me programe të tjera në vendet fqinje, të tilla si Bosnja dhe Hercegovina. Shkëmbimi i praktikave të mira konsiderohet i një rëndësie jetësore për të diskutuar sfidat dhe përmirësimet e mundshme në punën me kryerësit e dhunës në familje, për të qenë në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit.

KROACIA

Programe të detyrueshme kujdestarie dhe jo-kujdestarie për kryerësit e dhunës⁸⁴

Që nga fundi i viteve 2000, Kroacia ka njohur rëndësinë e punës me kryerësit e dhunës në familje dhe shkelësit e marrëdhënieve seksual. Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje⁸⁵, kryerësve të dhunës burra ose gra mund t'u kërkohet të marrin pjesë në një program, i cili mund të mbahet në komunitet ose në kujdestari, në varësi të faktit nëse lënda klasifikohet si kundërvajtje ose si rast penal. Kryesit që kanë kryer

82 Save the Children, Ambasada Norvegjeze, Komisioni i BE-së, SIDA dhe lamaneh Zvicër.

83 Organizata Gruaja tek Gruaja (WtW) themeloi Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD) për të kontribuar në zvogëlimin e dhunës në familje dhe sigurinë e viktimave duke ofruar shërbime të specializuara për kryerësit e dhunës. Më shumë informata gjenden në: gruajatekgruaja.com

84 Ky seksion bazohet në dy prezantime të mbajtura gjatë Konferencës Vjetore të WWP-së në vitin 2020 "Programet për burgje, shërbime sprovuese dhe kryerësit e dhunës - Bashkëpunimi për ndryshim", 2-3 shtator 2020. Ndërhyrja e Senka Damjanović (Dom Duga Zagreb, Kroaci), "Punëtorja 5: Modeli kroat i programeve për kryerësit e dhunës - Ngjashmëritë, dallimet dhe sfidat e programeve në komunitet dhe sistemin e burgjeve", gjendet në: <https://youtu.be/Y3h6E0A6Yok>. Fjalimi kryesor i bërë nga Jana Spero, Ndihmës Ministre në Drejtorinë për Burgje dhe Shërbimin Sprovues dhe Zëvendës Presidente e Konfederatës së Shërbimit Sprovues Evropian (CEP), "Puna me kryerësit e dhunës me bazë gjinore në sistemin kroat të drejtësisë penale", gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=OnY048pTnJQ&list=PLRmYyMTndST4QdrWys1pMtdWDn0zZbsWx&index=1>

85 Ligji u miratua në vitin 2003 dhe u ndryshua në vitin 2009: Parlamenti kroat, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Nezet 1(2), Zagreb (6 nëntor 2009).

krime me bazë gjinore në Kroaci përbëjnë një grup të vogël shkelësish kundrejt numrit të përgjithshëm të popullsisë. Sidoqoftë, janë bërë përpjekje të rëndësishme drejt këtij grupi në mënyrë që të frenohen pasojat e dhunës me bazë gjinore për viktimat dhe për shoqërinë në përgjithësi. Në shumicën e rasteve, gjykatat urdhërojnë një program trajtimi psikosocial si plotësim i dënimit penal dhe trajtimi specifik kognitiv i sjelljes sigurohet si në shërbimin sprovues ashtu edhe në burg.

Programi PSTN i bazuar në komunitet

I themeluar në vitin 2007, Dom Duga Zagreb është organizata e parë në Zagreb që ofron këshillim dhe mbështetje për gratë dhe fëmijët viktimat të dhunës në familje⁸⁶. Që nga viti 2009, ai përuroi edhe programin PSTN (trajtimi psikosocial i kryerësve të dhunës), i cili vlen vetëm për kryerësit e dhunës të akuzuar për kundërvajtje dhe kryhet në një mjedis jo-kujdestarie. Sot, ai është organizatë anëtare e WWP EN.

Nëse një kryerës i dhunës referohet programit, ai duhet të kalojë nëpër tri faza të ndryshme. Faza fillestare konsiston në dy deri në katër takime individuale, ku lehtësuesit njohin personin dhe situatën, vlerësojnë nivelin e motivimit dhe kontaktojnë sistematikisht viktimën. Faza e dytë është pjesa më e rëndësishme e programit. Kryerësit e dhunës marrin pjesë në seanca pune në grup çdo javë, për rreth dy orë, gjatë 16 javëve. Gjatë kësaj periudhe, stafi propozon disa module për të ilustruar forma të ndryshme të dhunës dhe pasojat e tyre, për të inkurajuar njohjen e abuzimit si një sjellje e zgjedhur. Profesionistët gjithashtu punojnë në shkathtësi për marrje përgjegjësish, komunikim dhe shkathtësi shoqërore dhe në adoptimin e marrëdhënieve pozitive, të respektueshme dhe të barabarta. Faza e vlerësimit fillon menjëherë pas përfundimit të programit dhe zgjat rreth gjashtë muaj. Gjykata merr njoftim të menjëhershëm për rezultatet dhe recidivizmin eventual të kryerësit të dhunës. Ekspertët nga Ministria e Drejtësisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e rezultateve të programit. Viktima gjithashtu informohet në mënyrë sistematike dhe ftohet të marrë pjesë në një takim ku stafi do të vlerësojë ndryshimet në qëndrimet dhe sjelljet e kryerësit e dhunës. Gjatë kësaj faze vlerësimi, profesionistët monitorojnë sjelljen e kryerësve të dhunës dhe aktet e reja të mundshme të dhunës.

Programi PSTN nuk është i kufizuar në burra kryerës të abuzimit të partneres intime, pasi ai gjithashtu pranon femra kryerëse të dhunës dhe kryerëse të formave të ndryshme të dhunës në familje, të tilla si dhuna ndaj prindërve të moshuar ose ndaj të miturve. Në secilën nga këto raste, ofruesit e shërbimeve duhet të rregullojnë modulet me llojin e shkelësit. Është e rëndësishme të theksohet se programi nuk pranon persona me çrregullime të rënda të shëndetit mendor, me probleme të varësisë ose me një motivim të ulët për të ndryshuar.

Ofrimi i sigurisë për viktimat është njëra nga shtyllat e programit dhe për këtë qëllim viktimat kontaktohen në disa faza. Në fillim të trajtimit në PSTN, viktimat mund të ofrojnë perspektivën e saj mbi marrëdhëniet dhe abuzimin; ajo merr informata në lidhje me të drejtat e saj dhe mbi shërbimet mbështetëse në dispozicion; ajo ftohet të komunikojë çdo ndryshim të rëndësishëm në sjelljen e kryesit. Viktimat gjithashtu do të kontaktohen pas përfundimit të programit ose nëse kryerësi i dhunës tërhiqet nga programi; në këtë rast, do të njoftohet edhe policia. Disa institucione marrin pjesë në mbështetjen e viktimave, në përputhje me "Protokollin kombëtar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje". Puna me kryerësit e dhunës konsiderohet si pjesë e një qasje gjithëpërfshirëse dhe e integruar në përgjigjen ndaj dhunës në familje.

Programi "Ju mund ta bëni ndryshe" të drejtuar nga Shërbimi Sprovues

Programi "Ju mund ta bëni ndryshe" është përfunduar në vitin 2018 dhe zbatohet nga Shërbimi Sprovues me fokus specifik në trajtimin e kryerësve të dhunës në familje. Programi është zhvilluar brenda kornizës së programeve mbështetëse të BE-së për zhvillimin e shërbimeve sprovuese. Në veçanti, kolegët nga "Drejtoria e Përgjithshme e Regjimit të Hapur dhe Dënimeve dhe Masave Alternative" në Ministrinë e Brendshme në Spanjë kanë ofruar trajnime specifike mbi masat e rehabilitimit për kryerësit e dhunës me bazë gjinore. Shumica e ofruesve të shërbimeve kanë përvojë në psikologji, punë sociale dhe pedagogji.

Programi bazohet në punën në grup (grupe nga 8 deri në 10 pjesëmarrës), por në rast të një numri të vogël të kryerësve të dhunës, në vend të kësaj mund të ofrohen seanca këshillimi individuale⁸⁷. Qëllimi kryesor i "Ju mund ta bëni ndryshe" është reduktimi DHBGJ. Objektiva të tjerë përfshijnë kufizimin e faktorëve të rrezikut, ndryshimin e qëndrimeve seksiste dhe promovimin e koncepteve të reja të shëndetshme të karakterit mash-

86 Më shumë informata gjenden në: www.duga-zagreb.hr

87 Për shembull, puna në grupe ishte e mundur në vitin 2018, por në vitin 2019 programi ofroi vetëm takime individuale.

kullor. Sikurse programi PSTN, ai është strukturuar në tri faza: një fazë motivuese, një fazë ndërhyrjeje dhe një fazë monitorimi. Gjatë fazës së motivimit (tri takime individuale), profesionistët vlerësojnë gjendjen personale të shkelësit, rrisin vetëdijen për pasojat dhe implikimet e sjelljes së kryerësit të dhunës, inkurajojnë motivimin për ndryshim, përcaktojnë qëllimet individuale me personin dhe zhvillojnë një plan për punën e ardhshme. Faza e ndërhyrjes përfshin 24 takime që mbulojnë disa tema (inteligjenca emocionale, vetëkontrolli, menaxhimi i zemërimit, empatia, xhelozia, dhuna psikologjike, marrëdhëniet e shëndetshme, mbrojtja e fëmijëve, parandalimi i akteve të reja të dhunës). Së fundmi, një fazë përcjellëse ka për qëllim monitorimin e ndryshimit në qëndrime dhe sjellje të kryerësit të dhunës gjatë rreth një muaji.

Meqenëse grupi i parë i shkelësve tregoi kënaqshmëri të madhe me programin, institucionet po planifikojnë zhvillimin e një projekti specifik hulumtues për të vlerësuar rregullisht efektivitetin e programit.

BOSNJA DHE HERCEGOVINA

Shoqata e Qytetarëve "Buducnost" Modrica

Shoqata e Qytetarëve "Buducnost" është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1996. Përveç lobiimit dhe avokimit, "Buducnost" punon në parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e të mbijetuarve, mbështetjen e grave në jetën publike dhe politike, rritjen e ndërgjegjësimit të grave dhe publikut të gjerë për të drejtat e tyre, si dhe sjelljeve dhe problemeve të ndryshme devijuese në shoqëri, me kapërcimin e barrierave etnike dhe duke kontribuar në procesin e ndërtimit të paqes në Bosnjë dhe Hercegovinë. Aktivitetet kryesore janë: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ato sociale; edukimi i qytetarëve, veçanërisht i grave dhe të rinjve, parandalimi i dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në bashkëpunim me institucionet dhe organet përkatëse përmes ofrimit të shërbimeve ligjore dhe avokimit: Linjat SOS, shtëpi e sigurt - strehë për gra dhe fëmijë; punë psikosociale me kryerësit e dhunës dhe punë edukative me djem të rinj; mbështetje emocionale, psikologjike dhe humanitare; humanizimi i marrëdhënieve midis gjinive; përmirësimi i kujdesit shëndetësor për gratë; punë humanitare për të mbështetur dhe ndihmuar individët dhe grupet e pafavorizuara.

Vive Zene - Tuzëll, Shoqata e Qytetarëve Tuzla (Tuzëll)

Vive Zene është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1994 gjatë luftës, e mbështetur nga gra prej Dortmundi, Gjermani. Fokusi kryesor është në ndihmën psikosociale dhe mbështetjen për viktimat e luftës, torturave dhe dhunës, dhe për të forcuar kapacitetin e organizatave dhe institucioneve të tjera dhe paraqesin një qasje shumë-disiplinore, demokratike dhe pjesëmarrëse në punën me familje dhe individë të traumatizuar. Me ekipin e tyre shumë-disiplinor, Vive Zene siguron një mbështetje efektive psikosociale përmes trajtimit me terapi familjare, psikoterapisë individuale dhe grupore, kujdesit mjekësor, konsultave dhe mësimdhënies sociale dhe ligjore, në qendër dhe komunitet.

SERBIA

OPNA është rrjeti kombëtar për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje.

Organizata është një rrjet joformal serb i 8 organizatave, e themeluar në vitin 2015. Organizatat anëtare gjenden në 8 qytete në Serbi dhe ofrojnë trajtim për burrat që përdorin dhunën ndaj partneres intime. Të gjitha organizatat anëtare ndjekin të njëjtat standarde të programit.

Rekomandime

Parandalimi

- Parandalimi është njëra nga katër shtyllat e Konventës së Stambollit (Kapitulli III) dhe paraqet sfondin për krijimin e programeve për kryerësit e dhunës (Konventa e Stambollit, neni 16).
- Kosova* është ende një shoqëri e pabarabartë gjinore dhe pikëpamjet tradicionale mbi rolet dhe detyrat e burrave dhe grave janë gjerësisht të përhapura. Qëndrimet seksiste dhe stereotipat gjinorë janë rrënja e dhunës ndaj grave dhe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e dhunës në familje. Normat kulturore shpesh ushqejnë tolerancën ndaj dhunës në baza gjinore, për shembull kryerësit e dhunës minimizojnë sjelljet e tyre të dhunshme, viktimat që tolerojnë abuzimin me partneren intime dhe profesionistët që nuk marrin parasysh madhësin dhe pasojat e shkeljeve të tilla. Stereotipet lidhur me gjininë gjithashtu pengojnë zhvillimin e potencialit të plotë të vajzave dhe djemve.
- Parandalimi i dhunës së burrave ndaj grave ka të bëjë me shoqërinë në tërësi dhe kërkon një larmi strategjish ndërhyrjeje, përfshirë iniciativa që synojnë djem dhe burra. Qëndrimet seksiste dhe sjelljet e dhunshme midis burrave të rinj dhe djemve, përfshirë studentëve, janë akoma të përsëritura. Punëtorët e strehimoreve gjithashtu kanë treguar disa raste djemsh, të strehuar në strehimore me nënat e tyre, duke treguar një potencial si kryerës të ardhshëm dhune. Strategjitë e parandalimit duhet të synojnë promovimin e marrëdhënieve të barabarta jo të dhunshme në fazat e hershme, para se ndonjë djalë apo burrë të bëhet kryerës i dhunës.

Rekomandime

- Zhvillimi i **iniciativa për ndërgjegjësim** të promovojë barazinë gjinore dhe të informojë publikun e gjerë për format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe ndikimin e tyre mbi viktimat dhe shoqërinë në tërësi (Konventa e Stambollit, neni 13). Shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare, sektori privat dhe media mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në hartimin e fushatave specifike që synojnë burra dhe djem, që synojnë të vënë në pikëpyetje rolet tradicionale gjinore dhe të promovojnë karakterin mashkullor me respekt jo të dhunshëm (Konventa e Stambollit, neni 17).
- Inkurajimi i iniciativave për barazi gjinore në **të gjitha nivelet e arsimit**, nga parashkollori deri në universitet (Konventa e Stambollit, neni 14). Mbështetja e projekteve **në mjedise formale dhe joformale**. Pranimi i rëndësisë së mësuesve, trajnerëve, kolegëve, udhëheqësve fetarë dhe të komuniteteve si **modele për t'u ndjekur** për forma alternative dhe më të barabarta të karakterit mashkullor.
- Ofrimi i **mundësive trajnimit** (trajnime fillestare dhe në ofrim shërbimesh) për të gjitha kategoritë e profesionistëve, përfshirë profesionistë të vijës së parë që merren me viktimat dhe kryerësit e dhunës (Konventa e Stambollit, Neni 15). Trajnimi duhet të përqendrohet në barazinë gjinore, në specifikat e dhunës në familje dhe në rëndësinë e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut. Një fokus i veçantë në mënyrën e identifikimit dhe trajtimit të kryerësve të dhunës në familje do të ishte i një rëndësie të madhe.

Korniza legjislative dhe politike për programet për kryerësit e dhunës

- Që nga viti 2004 autoritetet e Kosovës* kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të krijuar një kornizë legjislative dhe politike që adreson dhunën ndaj grave për të përmirësuar mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave. Sidoqoftë, legjislacioni aktual mbi programet për kryerësit e dhunës nuk është në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit. Në praktikë, Udhëzimet Administrative nr. 12/2012 dhe nr. 2/2013 kanë të bëjnë vetëm me kategori specifike të kryerësve të dhunës, përkatësisht shkelës me probleme të shëndetit mendor ose me probleme të varësisë nga alkooli ose droga, dhe nuk arrin të kapin një spektër më të gjerë të abuzuesve në familje.
- Aktualisht, Procedurat Standarde të Veprimit nuk parashikojnë udhëzime specifike për punën me kryerësit e dhunës në familje.
- Megjithëse disa dokumente të politikave parashikojnë krijimin e programeve për kryerësit e dhunës, shërbime të tilla nuk janë zbatuar për shkak të mungesës së njohurive, fondeve dhe infrastrukturës.
- Shërbimet që kanë të bëjnë me kryerësit e dhunës në familje nuk janë pjesë e Mekanizmave ekzistues Komunal të Koordinimit.

Rekomandime

- Zhvillimi i një **legjislacioni** specifik që synon krijimin e programeve të detyrueshme dhe vullnetare për kryerësit e dhunës në tërë Kosovën*.
- Përfshirja e masave specifike që synojnë kryerësit e dhunës në familje në **verzionin e amandamentuar të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje**.
- Përpunimi i një **kornize të saktë politikash** për të zhvilluar punën me kryerësit e dhunës në nivelin institucional dhe për të siguruar zbatim të saktë të programeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.
- Përfshirja e masave specifike që synojnë kryerësit e dhunës në familje në **Strategjinë e re kundër dhunës në familje** dhe sigurimi i vendosjes së afateve kohore reale për qëllime të arritshme. Për më tepër, sigurimi i monitorimit të procedurave për të verifikuar zbatimin konkret të masave të politikave në këtë fushë.
- Paraqitja e udhëzimeve specifike për veprim në **PSV** për të garantuar që puna me kryerësit e dhunës të merret në konsideratë brenda përgjigjes ndërinstitucionale ndaj dhunës në familje.

Qasja në programet për kryerësit e dhunës

- Deri më sot, programe specifike për kryerësit e dhunës në familje janë në dispozicion vetëm në Prishtinë (Qendra Sit) dhe në Gjakovë (Shtëpia e Sigurt), në bazë të vetë-referimit ose përmes shërbimit sprovues në zbatimin e një dënimi. Këto përvoja fillestare mbeten të panjohura për shumicën e njerëzve dhe duhet të zhvillohen më tej në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Sipas legjislacionit aktual, referimi i kryerësve të dhunës për trajtim mund të bëhet vetëm në bazë të një urdhri gjykate ose si masë mbrojtëse. Aktualisht, numri i përafërt i kryerësve të dhunës që ndjekin trajtimin e detyrueshëm është i ulët.
- Programet e menaxhimit të zemërimit për shkelësit e dënuar janë në dispozicion në disa qendra të paraburgimit në Kosovë*. Sidoqoftë, në sistemin e burgjeve nuk ofrohet asnjë program specifik që synon kryerësit e dhunës në familje.
- Institucionet shëndetësore publike, të tilla si Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës*, janë përgjegjës për ofrimin e trajtimit të kryerësve të dhunës. Qasja në institucionet shëndetësore është e kufizuar dhe nuk përputhet me standardet.

Rekomandime

- Inkurajimi i **shpërndarjes gjeografike** të programeve, duke i vënë në dispozicion qendrat e vogla në nivelin komunal në territorin e Kosovës*, në vend të vetëm një shërbimi qendror për kryerësit e dhunës.
- Sigurimi i **llojeve të ndryshme të programeve për kryerësit e dhunës** (vullnetar dhe i detyrueshëm; në mjedise kujdestarie dhe jo-kujdestarie), sipas llojeve të ndryshme të shkeljes.
- Sigurimi që **referimi** në programe **të përfshijë të gjithë kryerësit** e dhunës në familje, pa u kufizuar në kategori specifike të shkelësve. Nëse personi paraqet nevoja të veçanta, të tilla si varësia nga alkooli dhe droga ose probleme të shëndetit mendor, duhet të garantohet referimi në shërbime të tjera të specializuara.
- Mundësimi i **referimit** në programe për kryerësit e dhunës **në faza të ndryshme**: gjatë paraburgimit, në procedurat civile, si plotësim i një urdhri mbrojtje, në procedurë penale, në burg dhe si përcjellje pas lirit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse mund të inkurajojë viktimat të raportojnë, pasi gratë do të shohin ndryshime në sjelljet e kryerësve të dhunës edhe në fazat e hershme të dhunës, para se të përshkallëzohet në forma më serioze të abuzimit.
- Alokimi i **burimeve financiare** të mjaftueshme për zhvillimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të programeve për kryerësit e dhunës, sesa buxhetet afatshkurtra për projekte të rastit. Inkurajimi dhe pranimi i aleancave midis programeve për kryerësit e dhunës dhe shërbimeve mbështetëse të grave për të shmangur konkurrencën për financim.
- Mbështetja e programeve të iniciuara nga **Shtëpia e Sigurt** në Gjakovë dhe nga **Qendra Sit** në Prishtinë, duke ofruar financim të mjaftueshëm dhe mbështetje teknike (mundësi trajnimi, bashkëpunim me institucione të tjera, pjesëmarrje në rrjete vendore dhe ndërkombëtare, etj.). Përvojat e këtyre dy qendrave lokale mund të zhvillohen më tej dhe mund të shërbejnë si frymëzim për shërbimet e tjera në Kosovë*.

Politikat e koordinuara dhe bashkëpunimi me shërbimet mbështetëse të grave

- Megjithëse ekzistojnë mekanizma komunal të koordinimit për dhunën në familje në Kosovë*, implementimi efektiv i tyre është ende sfidë. Bashkëpunimi i pasuksesshëm midis shërbimeve është identifikuar si pengesë kryesore për përgjigje adekuat ndaj dhunës në familje.
- Deri më sot, puna me kryerësit e dhunës nuk është e integruar në përgjigjen ndërinstitucionale ndaj dhunës në familje.
- Organizata të tilla si Qendra Sit në Prishtinë dhe Shtëpia e Sigurt në Gjakovë kanë zhvilluar praktika eksperimentale që synojnë kryerësit e dhunës dhe kanë bërë përpjekje të rëndësishme në bashkëpunimin me organizata të tjera. Sidoqoftë, marrëveshjet zyrtare midis shërbimeve dhe procedurave specifike për të kontaktuar gratë viktime nuk janë bërë ende.

Rekomandime

- Adoptimi i një **qasjeje gjithëpërfshirëse** në përgjigjen ndaj dhunës në familje, duke u përqendruar në gra, fëmijë dhe kryerës të dhunës.
- Inkurajimi për zhvillim të **marrëveshjeve specifike midis programeve për kryerësit e dhunës dhe institucioneve të tjera**.
- Përmirësimi i mekanizmave ekzistues të koordinimit për të siguruar **sistem efektiv referimi, shkëmbim të informacionit dhe vlerësim të koordinuar të rrezikut** midis shërbimeve. Institutet shëndetësore, QPS, shërbimi sprovues dhe korrektues, drejtorja e burgut dhe policia duhet të përfshihen të gjitha në frenimin e dhunës së burrave dhe monitorimin e sjelljes së kryerësve të dhunës.
- Krijimi *ad hoc* i **protokolleve midis programeve për kryerësit e dhunës dhe shërbimeve mbështetëse të grave**, për të siguruar një përgjigje të koordinuar dhe efektive ndaj dhunës në familje dhe për të monitoruar ndryshimet në sjelljen e kryerësit të dhunës. Punëtorët e strehimoreve përbëjnë aleatë strategjikë në detyrën e koordinimit, pasi ata e dinë sipas përvojës dinamikën specifike të pushtetit dhe kontrollit që nënvizojnë kryerjen e dhunës.
- Sigurimi i **mbledhjes së koordinuar të të dhënave** për rastet e kryerësve të dhunës në familje midis shërbimeve.
- **Vlerësimi i rregullt i ndikimit** të programit në parandalimin e akteve të reja dhe më të rënda të dhunës.

Perspektiva gjinore dhe pajtueshmëria me standardet ndërkombëtare

- Në Kosovë* dhuna e burrave ndaj partnereve intime konsiderohet ende si pasojë e abuzimit me alkoolin dhe drogën ose i problemeve të shëndetit mendor. Për më tepër, shpesh lidhet me papunësi, analfabetizëm dhe varfëri.
- Disa profesionistë që punojnë në shërbime dhe institucione të ndryshme nuk e kanë kuptuar DhF-në si një dhunë të bazuar në gjini dhe u mungon vlerësimi i kryerësve të dhunës si burra që qëllimisht e përdorin dhunën për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi partneret e tyre, pavarësisht nga faktorët e tjerë.
- Trajtimi aktualisht në dispozicion në Kosovë* për kryerësit e dhunës në familje nuk bazohet në të kuptuarit gjinor të dhunës në familje. Kryerësit e dhunës në familje nuk duhet të barazohen me shkelësit e tjerë të zakonshëm. Nëse trajtimi ofrohet në kontekstin e shërbimeve sprovuese dhe korrektuese, në sistemin e burgjeve ose në institucionet shëndetësore publike, programet duhet të adresojnë specifikat e kësaj popullate dhe t'i lidhin ato me pabarazitë ekzistuese strukturore gjinore. Prandaj, programet që synojnë kryerësit e dhunës nuk duhet të reduktohen në abuzimin me alkool dhe substanca, menaxhim të zemërimit, ose mjekim.
- Programet për kryerësit e dhunës nuk duhet të synojnë pajtimin e partnerëve ose ofrimin e ndërmjetësimit ndërmjet bashkëshortëve. Frenimi i dhunës së burrave duhet të shoqërohet me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurisë së viktimave. Dhuna ndaj grave në kontekstin e marrëdhënieve intime është një sjellje e zgjedhur dhe kryerësit e dhunës duhet të mbajnë veten përgjegjës për veprimet e tyre.

Rekomandime

- Promovimi i **iniciativa për ndërgjegjësim** mbi barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit.
- Inkurajimi i **zhvillimit të njohurive dhe kompetencave specifike** mbi programet për kryerësit e dhunës, sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira. Mundësitë e trajnimit mund të përfshijnë vendimmarrës dhe agjenci shtetërore, si dhe kategori të ndryshme profesionale në nivelin qendror dhe lokal.
- Krijimi i procedurave specifike që **vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut** të kryhen në kohë të caktuara, gjatë pjesëmarrjes së kryerësve të dhunës në program.
- Rritja e kapaciteteve të **profesionistëve** të vijës së **parë** të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për kryerësit e dhunës, duke i përfshirë trajnimin fillestar dhe trajnimin gjatë shërbimit
- Ofrimi i **trajnimeve** për profesionistë që ofrojnë programe për kryerësit e dhunës, me fokus specifik në dhunën në familje si dhunë me bazë gjinore.
- Mbështetja e **vizitave studimore, shkëmbimeve trajnimi dhe takimeve** me profesionistë nga vende të tjera ose me organizata anëtare të WWP EN.
- Shfrytëzimi i përvojës dhe **mbështetjes së WWP EN**.

Standardet dhe udhëzimet vendore

- Aktualisht në Kosovë* nuk ekzistojnë standarde dhe udhëzime uniforme për punën me kryerësit e dhunës. Profesionistët që merren me kryerësit e dhunës në disa institucione nuk ndjekin protokolle specifike për veprim, të cilat sjellin disa rreziqe për viktimat.
- Iniciativat e izoluara eksperimentale që synojnë kryerësit e dhunës, të tilla si Qendra Sit në Prishtinë dhe Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, u inspiruan nga qasje të ndryshme të njohura ndërkombëtarisht. Sidoqoftë, profesionistët që punojnë në këto dy shërbime nuk kanë ndarë përvojat e tyre dhe as nuk kanë përpunuar udhëzime të përbashkëta për praktikën.

Rekomandime

- Realizimi i një **vlerësimi nevojash** midis shërbimeve që merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me kryerësit e dhunës në familje, për të identifikuar kërkesat praktike të shprehura nga shërbimet dhe institucionet lokale në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës. Duke punuar në kontakt të ngushtë me viktimat, shërbimet mbështetëse të grave kanë zhvilluar historikisht kompetenca të rëndësishme në këtë fushë dhe duhet të përfshihen në mënyrë aktive në këtë proces.
- Inkurajimi i krijimit të një **grupi punues** për të zhvilluar standarde, për të përcaktuar udhëzime dhe për të caktuar kriteret licencimi për punën me kryerësit e dhunës në familje. Nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, Koordinatorit Nacional për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, grupi punues duhet të përbëhet nga shoqëria civile, duke përfshirë shërbimet për mbështetjen e grave, institucionet e Kosovës* dhe organizatat ndërkombëtare.
- Zhvillimi i **standardeve** për të harmonizuar përvojat ekzistuese në punën me kryerësit e dhunës në të gjithë Kosovën*, të frymëzuar nga praktikat ndërkombëtare dhe të përshtatura në kontekstin specifik të Kosovës*.
- Përcaktimi i **udhëzimeve specifike** dhe **kurrikulave të strukturuar** për krijimin konkret të programeve për kryerësit e dhunës, të cilat do të përfshinin një qasje shumë-dimensionale ndaj kryerësve të dhunës dhe një perspektivë gjinore. Përmbajtja e moduleve do të përshtatet me mjedisin, llojin e veprës, shkallën e dhunës, nivelin e motivimit të pjesëmarrësve.
- Caktimi i **kritereve transparente të licencimit** për programet për kryerësit e dhunës.
- Mbështetja e krijimit të një **rrjeti të programeve për kryerësit e dhunës** dhe shërbimeve në të gjithë Kosovën*.
- **Mbledhja sistematike e të dhënave** me qëllim të vlerësimit të ndikimit të programeve dhe matjes së recidivizmit.
- Favorizimi i **shkëmbimeve të informatave dhe praktikave** në kontekstin e Kosovës* dhe me vendet e tjera në rajon.

Shtojca I: Korniza për barazi gjinore dhe kundër dhunës ndaj grave

Legjislacioni kryesor

- Kushtetuta e Kosovës. Përmes nenit 22 të Kushtetutës, disa Konventa Ndërkombëtare janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë* dhe kanë përparësi mbi legjislacionin kombëtar. Kjo përfshin Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave. Gjithashtu, që nga Shtatori 2020, Kuvendi i Kosovës* ka aprovuar amendament Kushtetues që e bën drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë edhe Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – Konventën e Stambollit.
- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, 2015, përcakton dhe ndalon dhunën me bazë gjinore (neni 4)
- Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, (2010). Nenet 4 dhe 9 rregullojnë trajtimin psikosocial, si dhe abuzimin me alkoolin dhe drogën për kryerësit e dhunës në familje, që do të nxjerrën në kombinim me masat e tjera mbrojtëse të parashikuara në ligj.
- Kodi Penal i Kosovës Nr. 04/L-082. Reforma e kohëve të fundit e Kodit Penal më 14 prill 2019 (neni 248) përcakton dhunën në familje si më poshtë: “1. Kushdo që kryen dhunë fizike, psikologjike ose ekonomike ose keqtrajtim me qëllim të cenimit të dinjitetit të një personi tjetër brenda një marrëdhënie familjare dënohet me burgim nga një dhe deri në tre vjet.”
- Ligji Nr. 04/L-172. Rregullorja nr. 22/2015 Për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës*
- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësit të dhunës në familje
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 për caktimin e trajtimit të abuzimit me alkoolin dhe substanca

Standardet dhe udhëzimet

- Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë* (2013), të publikuara nga Agjencia për Barazi Gjinore
- Udhëzimet për politikën e dënimeve në Kosovë të nxjerra nga Gjykata Supreme e Kosovës* në vitin 2018

Strategjitë

- Programi i Kosovës dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014 (2011)
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (2016). Një nga shtyllat kryesore të Strategjisë është “Rehabilitimi dhe ri-integrimi” (Shtylla 4), e cila parashikon “krijimin e institucioneve të rehabilitimit dhe qendrave të këshillimit me programe të detyrueshme për kryerësit e dhunës në familje” (Objektivi Specifik 4.4.)
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2020-2024)

Shtojcë II : Lista e subjekteve të konsultuara

Autoritetet kombëtare

- Ministria e Drejtësisë
- Agjencia për Barazi Gjinore
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Organet publike

- Shërbimi Kombëtar Sprovues, zyra e Gjakovës
- Instituti i Psikiatrisë Forenzike
- Shërbimi Korrektues, Njësia për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve

Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

- Rrjeti i Grave të Kosovës
- "Shtëpi e sigurt", strehimorja në Gjakovë
- Qendra Sit
- Instituti Kosovar për Kërkime Politike dhe Zhvillim
- Rrjeti Evropian i Punës me Kryerësit e Dhunës
- Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem, Tiranë

Organizata ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

- UN Women
- UNFPA

Referenca

Agjencia për Barazi Gjinore (2019) *Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë*, Prishtinë.

Agjencia për Barazi Gjinore (2020) *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024*, Prishtinë. Gjetet në: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>

Qendra për Studime Sociale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm (2019), *Stereotipet Gjinore dhe Zgjedhjet në Karrierë në Kosovë*. Gjetet në: http://helvetas-ks.org/eye/file/repository/LEAP_projekti_eng_print_v1_3_.pdf

Këshilli i Evropës (2002) *Rekomandimi Rec 2002 (5) mbi mbrojtjen e grave nga dhuna*, Këshilli i Evropës, Strasburg.

Këshilli i Evropës (2008) *Luftimi i dhunës ndaj grave: standardet minimale për shërbimet mbështetëse*, Këshilli i Evropës, Strasburg.

Këshilli i Evropës (2011), *Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*, Këshilli i Evropës, Strasburg. CETS Nr.210

Këshilli i Evropës (2014) *Programet për Kryerësit e Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale: Neni 16 i Konventës së Stambollit*. Strasburg: Këshilli i Evropës.

Këshilli i Evropës (2017) *Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë**, Këshilli i Evropës, Strasburg.

Farnsworth, N., & Qosaj-Mustafa, A. (2008). *Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për të ofruar informata për Strategjinë e parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë* (Agjencia për Barazi Gjinore). Prishtinë. Gjetet në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130715145730743-1.pdf>

Agjencia e të Drejtave Themelore (2014) *Dhuna ndaj Grave: Një studim në gjithë BE-në*. Vjenë: FRA.

Gondolf E.W. (1985) *Burrat që rrahin (Men Who Batter): Një Qasje e Integruar për Ndalimin e Abuzimit të Gruas*. Holmes Beach, FL: Learning Publications.

Gondolf E.W. (2012) *E Ardhmja e Programeve për Dhunuesit. Rivlerësimi i praktikave të bazuara në prova*.

Gondolf EW, Russell D. (1986) The Case Against Anger Control Treatment Programs for Batterers, *Përgjigja*, 9 (3): 2-5.

Hagemann-White et al. (2010) *Faktorët në lojë në kryerjen e dhunës ndaj grave, dhunës ndaj fëmijëve dhe dhunës në orientimin seksual - Një model ndërveprues shumë nivelësh*. Gjetet në: <https://www.humanconsultancy.com/assets/understanding-perpetration/understanding-perpetration.html>

Hearn, J. (1998) *Dhuna e burrave: si flasin burrat dhe si reagojnë agjencitë ndaj dhunës së burrave ndaj grave*, Sage.

Kelmendi, K. (2015) "Dhuna në familje ndaj Grave në Kosovë: Një studim cilësor i përvojave të grave", *Gazeta e Dhunës Ndërpersonale* 2015, vëll. 30(4) 680–702.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019a) *Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës*, Prishtinë. Gjetet në: <https://ask.rks-gov.net/media/4901/poverty-statistics-2012-2017.pdf>

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019b) *Anketë e Fuqisë Punëtore 2019*, Prishtinë. Gjetet në: <https://ask.rks-gov.net/media/5412/labour-force-survey-2019.pdf>

Rrjeti i Grave të Kosovës (2008) *Hulumtim shpjegues mbi shkallën e dhunës mbi baza gjinore në Kosovë dhe ndikimi i saj në shëndetin riprodhues të grave*, Prishtinë.

Rrjeti i Grave të Kosovës (2015), *Mjaft më me arsytetime: Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, Rrjeti i Grave të Kosovës, Prishtinë. Gjetet në: <https://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025622.pdf>

Rrjeti i Grave të Kosovës (2016) *Ngacmimi Seksual në Kosovë*, Prishtinë. Gjetet në: <https://womensnetwork.org/publications/sexual-harassment-in-kosovo/>

Rrjeti i Grave të Kosovës (2018), *Analiza Gjinore e Kosovës*, Prishtinë. Gjetet në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2019) *Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2018-2019*, Prishtinë. Gjetet në: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/08/education-statistics-2018-2019.pdf>

Ministria e Drejtësisë (2015) *Raport i Vlerësimit të Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014*, Prishtinë. Gjetet në: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Evaluation%20of%20NSAPDV%20english.pdf>

Ministria e Drejtësisë (2016) *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020)*, Prishtinë.

D. Morina (2019) "Dhuna me bazë gjinore në Kosovë: Shqyrtim kritik i përgjigjes së policisë, ERAC, Prishtinë. Gjetet në: http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender_base_violence_eng-1.pdf

OSBE (2019a) *Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë*, gjendet në: https://www.osce.org/files/Report%20on%20Shelters%20for%20victims%20of%20domestic%20violence%20in%20Kosovo_eng.pdf

OSBE (2019b) *Mirëqenia dhe siguria e grave. Raporti kryesor*. Gjetet në: https://www.osce.org/files/f/documents/9/2/413237_0.pdf

OSBE/UNFPA (2018), *Perspektiva e burrave ndaj barazisë gjinore në Kosovë* Gjetjet kryesore nga Anketa Ndërkombëtare për Burrat dhe Barazinë Gjinore (IMAZHE)*. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/7/e/382507.pdf>

Pawlak, Krasniqi dhe Selaci (2016) *Vlerësimi i dinamikës së pushtetit dhe gjinive në Kosovë, Raporti përfundimtar*, USAID.

Pence E., Paymar M. (1993) *Grupet arsimore për burrat që rrahin: Modeli Duluth*. Nju Jork: Springer.

A. Qosaj-Mustafa, D. Morina. (2018) "Qasja në Drejtësi për Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*: Përfundimi i mosndëshkimit për kryerësit e dhunës, Shoqëria Civile për të Drejtat e Njeriut, Prishtinë. Gjetet në: https://www.cshr-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/Accessing_Justice_for_Victims_of_Gender_Based_Violence_in_Kosovo_Ending_Impunity_for_Perpetrators_820425.pdf

Doracak i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (2010) për legjislacionin mbi dhunën ndaj grave. Gjetet në: <https://www.un.org/womenwatch/daw/vaw/handbook/Handbook%20for%20legislation%20on%20violence%20against%20women.pdf>

USAID (2018) *Vlerësimi gjinor, Lgbti dhe personave me aftësi të kufizuara*. Gjetet në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00T8D4.pdf

WAVE (2017) *Standardet e parandalimit dhe mbështetjes për gratë mbijetuese të dhunës - Doracak për zbatimin e Konventës së Stambollit*. Gjetet në: http://files.wave-network.org/trainingmanuals/WAVE_Handbook_2017.pdf

WAVE (2019) *Krijimi i hartës së shërbimeve për dhunën seksuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë*. Gjetet në: https://cssplatform.org/wp-content/uploads/2019/10/CSSPWAVE_SVReport190927_web.pdf

Westmarland N., Kelly L. (2012) "Pse zgjerimi i matjeve të 'suksesit' në programe për kryerësit e dhunës në familje është i rëndësishëm për punë sociale' *Gazeta Britanike e Punës Sociale* 1, 19;

Westmarland N., Kelly L. (2016) "Programe për kryerësit e dhunës dhe dhunës seksuale ndaj partnerit intim. Gjetet nga hulumtimi i projektit Mirabal". Në: McOrmond Plummer L et al. (eds) *Kryerësit e Dhunës ndaj Partnerit Intim*. Londër: Routledge, f. 190–205

Westmarland N., Kelly L., Chalder-Mills, J. (2010) *Programet për kryerësit e dhunës në familje: çfarë llogaritet si sukses?*, Universiteti Metropolitan i Londrës dhe Universiteti Durham, Londër dhe Durham. Gjetet në: <https://dro.dur.ac.uk/11515/>

WWPEN (n.d.) *Udhëzime për të zhvilluar standarde*. Gjetet në: <https://www.work-with-perpetrators.eu/resources/guidelines>

WWP EN (2019) *Programet e bazuara në shërbim sprovues dhe burgje për kryerësit e dhunës në familje dhe seksuale: një përmbledhje evropiane*. Gjetet në: https://www.work-with-perpetrators.eu/fileadmin/WWP_Net-work/redakteur/Expert%20Essays/Expert_paper_prison_and_probation_final.pdf

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, duke i përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE